

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5554  
E premte, 17 gusht 2018  
çmimi 0.40 €

Liberalizimi i vizave, më  
29 gusht pjesë e agjendës  
së Komitetit LIBE | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## AKTUALE

**KRERËT E  
OKTAPODIT DHE  
PESHKAQENI I  
MADH** F. 13

Bedri ISLAMI



**GJERMANIA PËRSËRIT SE  
KUFIJTË NUK NDRYSHOJNË**

F. 6

**PRISHTINA DO T'I KETË EDHE  
PESË SHKOLLA TË REJA** F. 6

## EKONOMI

**GJERMANIA JEP 6.5  
MILIONË EURO PËR KRIJIMIN  
E VENDEVE TË PUNËS  
NË BUJQËSI** F. 9

**KOSOVA DHE SHQIPËRIA ME  
KAMPANJË 'BLEJ SHQIP'** F. 8

## KULTURË

**NË VLORËN  
HISTORIKE** F. 14

Bedri TAHIRI



## SPORT

**AHMETI: FUTBOLLI I  
KOSOVËS ËSHTË NË RRUGË  
TË DUHUR**

**KOSOVA PËSON HUMBJE  
NGA BULLGARIA  
NË EVROPIANIN U18** F. 16

FLET PËR "EPOKËN E RE", AFRIM HOTI | FAQE 4-5

## Korrigjimi i kufirit s'mund të bëhet pa mbështetjen e fuqive të mëdha

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti, e ka quajtur paradoksale që në këto rrethana të flitet për korrigjim të kufirit Kosovë - Serbi. Ai ka thënë se është i pamundur korrigjimi i kufirit për faktin se të dy shtetet nuk e njohin njëri-tjetrin dhe nuk kanë raporte të konsoliduara e as komunikim diplomatik. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoti ka deklaruar se ideja për korrigjimin e kufirit me Serbinë është e pazbatueshme meqë nuk përkrahët nga vendet e fuqishme. Ai ka vlerësuar se Kosova duhet të jetë pjesë e dialogut, por në asnjë mënyrë të bëjë koncesione të cilat do të bartnin rrezikshmëri për funksionalitetin e shtetit



## Gucati fton Prokurorinë ta vazhdojë punën e Blakajt

Kryetari i OVL-UÇK-së, Hysni Guçati, ka bërë me dije se çështja e hetimit të keqpërdoruesve të listave të veteranëve të luftës së UÇK-së nuk duhet të ndalet pavarësisht prej dorëheqjes së ish-prokurorit special Elez Blakaj. Nëpërmjet gazetës "Epoka e re" ai e ka ftuar kryeprokurorin Aleksandër Lumezi ta vazhdojë punën nëse ka prova se 19 mijë veteranë kanë fituar statusin kundërligjshëm. Kurse ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka deklaruar se hetimi i keqpërdoruesve të listave të veteranëve të luftës do ta rikthente dinjitetin e plotë të veteranëve të vulosur nga historia | FAQE 3



## Suhareka, në gjendje të rëndë pas vërshimeve

Të mërkurën në mbrëmje Komuna e Suharekës me fshatra përreth është përfshirë nga një mot i lig i përcjell me të reshura të mëdha shiu. Si pasojë e vërshimeve janë dëmtuar shumë rrugë, shtëpi banimi dhe objekte të institucioneve të ndryshme | FAQE 6

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Kurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Prizren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob.: +377(0) 44 506 815  
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [sat\\_styro@yahoo.com](mailto:sat_styro@yahoo.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## KE: Prishtina e Beogradi kanë përcaktuar temat e bisedimeve

**BRUKSEL, 16 GUSHT** - Komisioni Evropian ka bërë me dije se Beogradi dhe Prishtina zyrtare janë pajtuar se për çfarë temash do të bisedojnë në takimin e radhës, me ndërmjetësimin e BE-së. Zëdhënësi i Komisionit Evropian, Karlos Martin, theksoi se kryetarët e të dy vendeve, Kosovës dhe Serbisë, Thaçi e

Vuçiçi, janë pajtuar të shtohet dialogu dhe të takohen në shtator. "Është në dorën e tyre të përcaktojnë se për çfarë temash do të bisedojnë, ndërkaq roli ynë është të ndërmjetësojmë në dialog", ishte përgjigjja e Martin, në pyetjen e cila kishte të bënte nëse në këtë takim do të flitet edhe për çështjen e



ndryshimit të kufirit, njoftojnë mediet serbe.

Tutje, Martini shtoi se në kuadër të dialogut në nivelin e lartë, që u mbajt më 24 qershor, Thaçi e Vuçiçi kishin një bisedim intensiv dhe konstruktiv, ku edhe janë pajtuar të takohen sërish në shtator dhe që do ta vazhdojnë edhe më intensivisht aktivitetin për zgjidhjen e përhershme të çështjes së

Kosovës. "Dialogu me ndërmjetësimin e BE-së ka si synim arritjen e një zgjidhjeje të përhershme mes të dyja palëve, të ndihmojmë në gjetjen e zgjidhjes dhe të krijojnë përparime në rrugëtimin e tyre drejt BE-së dhe në përmirësimin e jetës së qytetarëve", tha Martin.

## Ushtarët amerikanë stërviten në Maqedoni

Pjesëtarë të Ushtrisë amerikane në kuadër të forcave paqeruajtëse në Kosovë dhe nga baza të tjera në Evropë po marrin pjesë në një stërvitje në poligonin ushtarak Krivollak në Maqedoninë Qendrore. Autoritetet maqedonase thonë se aleatëve të NATO-s po u ofrojnë kushte për trajnime të forcave tokësore dhe ajrore



siguria prodhojnë mirëqenie dhe se mekanizmi i NATO-s më së miri e siguron qëndrueshmërinë. "Mirëqenia e garanton zhvillimin. Vlerësoj se Maqedonia do të jetë anëtare e ardhshme e NATO-s dhe për këtë e ka mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës", tha Schweitzer-Bluhm. "Partneriteti midis Maqedonisë dhe NATO-s do të jetë edhe më i fortë atëherë kur Maqedonia të bëhet anëtare e Aleancës. Shtetet e Bashkuara dëshirojnë ta shohin Maqedoninë që t'i plotësojë kushtet për anëtarësim në Aleancë dhe ne inkurajojmë qytetarët e Maqedonisë të bëhen pjesë e këtij procesi", theksoi ajo. Sipas autoriteteve në Shkup, ekonomia lokale ka përfituar 4-5 milionë dollarë vetëm nga shpenzimet dhe prania e forcave të shtuara ushtarake të vendeve të NATO-s.

**SHKUP, 16 GUSHT** - Pjesëtarë të Ushtrisë amerikane po marrin pjesë në një stërvitje në poligonin ushtarak Krivollak në Maqedoninë Qendrore. Ata janë anëtarë të forcave paqeruajtëse në Kosovë dhe nga baza të tjera në Evropë. Autoritetet maqedonase thonë se po u ofrojnë aleatëve të NATO-s kushte për trajnime të forcave tokësore dhe ajrore. Ministria maqedonase e Mbrojtjes, Radmilla Sheqerinska, tha se anëtarësimi i

Maqedonisë në NATO paraqet një mundësi për një rajon të sigurt dhe paqe për qytetarët. Ajo tha se Maqedonia ka vuajtur mjaft nga konfliktet dhe se anëtarësimi në NATO do t'u jepte fund këtyre problemeve. "Angazhohemi që i gjithë Ballkani të jetë një rajon i qëndrueshëm dhe, para së gjithash, angazhohemi që vendi ynë dhe qytetarët tanë të jenë të sigurt", tha Sheqerinska duke iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me sfidat e mundshme në rajon në

kohën që po zhvillohen debate për ndryshim ose korigjim të kufijve midis Kosovës dhe Serbisë. Ministria maqedonase pret që qytetarët e Maqedonisë t'i japin mbështetje të fortë anëtarësimi

në NATO dhe në BE në referendumin e pritshëm në fund të shtatorit. Edhe zëvendësambasadorja amerikane në Maqedoni, Micaela Schweitzer-Bluhm, theksoi se qëndrueshmëria dhe

## ShBA-ja mbështet Shqipërisë në luftën kundër krimit të organizuar



**TIRANË, 16 GUSHT** - Zëvendësministrja e Brendshme të Shqipërisë, Romina Kuko, po zhvillon një vizitë në ShBA, me ftesë të Departamentit të Shtetit. Në agjendën e kësaj vizite janë programet e shkëmbimit të përvojës në fushën e sundimit të ligjit si dhe ato për luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Kuko ka zhvilluar takime zyrtare në Byronë e Kundër terrorizmit, në Byronë e Çështjeve Evropiane si dhe në Departamentin e Sigurisë së

Brendshme (Homeland Security). Gjatë këtyre takimeve u rikonfirmua mbështetja amerikane ndaj Shqipërisë për luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Po ashtu, u vlerësuan hapat e ndërmarrja në fushën e hetimit të përbashkët si një dëshmi e bashkëpunimit konkret mes agjencive të zbatimit të ligjeve të të dy vendeve. Ndërsa palët u pajtuan për shtimin e programeve të asistencës në sistemet teknologjike dhe burimet njerëzore në fushën e hetimit të përbashkët.

Zëvendësministrja Kuko zhvilloi gjithashtu disa takime të frytshme në Institutin e ShBA-së për Paqe dhe në Qendrën e Hulumtimit Teknologjik, ku u diskutua rreth luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm. Në këto takime Kuko prezantoi masat e marra nga Shqipëria në këtë drejtim dhe u diskutua edhe për realizimin e një projekti konkret të përbashkët. Në tryezat e zhvilluara u shkëmbyen përvojat specifike në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm.

## Vuçiçi dhe ambasadori Scott diskutojnë për Kosovën

**BEOGRAD, 16 GUSHT** - Presidenti serb Aleksandër Vuçiçi është takuar me ambasadorin amerikan në Beograd, Kyle Scott. Mediet serbe raportojnë se Scott dhe Vuçiçi shkëmbyen pikëpamjet mbi vazhdimin e

dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Vuçiçi theksoi nevojën që të arrihet një kompromis që do të garantonte stabilitet dhe përparim ekonomik. Të dy u dakorduan se dialogu është mënyra më e mirë për t'i

përmirësuar raportet mes dy shteteve. Scott u bëri thirrje Beogradit dhe Prishtinës për të treguar guxim, fleksibilitet dhe kreativitet për marrjen e vendimit. Ditët e fundit zyrtarët e lartë

serbë kanë pretenduar se Amerika ka ndërruar qëndrim në lidhje me Kosovën. Madje, sipas raportimeve të medieve serbe, administrata e re e Trumpit e përkrah edhe ndarjen e Kosovës.



Dorëheqja e ish-prokurorit special Elez Blakaj, i cili ka qenë duke hetuar keqpërdorimin e listave të veteranëve të UÇK-së, ka nxitur reagime të shumta

# Gucati fton Prokurorinë ta vazhdojë punën e Blakajt



Kryetari i OVL-UÇK-së, Hysni Guçati, ka bërë me dije se çështja e hetimit të keqpërdoruesve të listave të veteranëve të luftës së UÇK-së nuk duhet të ndalet, pavarësisht prej dorëheqjes së ish-prokurorit special Elez Blakaj. Nëpërmjet gazetës "Epoka e re" ai e ka ftuar kryeprokurorin Aleksandër Lumezi ta vazhdojë punën nëse ka prova se 19 mijë veteranë kanë fituar statusin kundërligjshëm. Kurse ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka deklaruar se hetimi i keqpërdoruesve të listave të veteranëve të luftës do ta rikthente dinjitetin e plotë të veteranëve të vulosur nga historia

**EPOKA  
ERE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 16 GUSHT** - Kryetari i OVL-UÇK-së, Hysni Guçati, ka ftuar Prokurorinë e Shtetit ta vazhdojë punën e ish-prokurorit special Elez Blakaj, i cili ka qenë duke hetuar keqpërdorimin e listave të veteranëve të UÇK-së. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Prokuroria duhet ta çojë deri në fund këtë çështje dhe ta zbardhë të vërtetën. "Nëse Blakaj ka dhënë dorëheqje, besoj se shteti i Kosovës ka prokurorë të tjerë që ta vazhdojnë punën aty ku e ka lënë Blakaj. Pra, ky proces nuk duhet të ndalet këtu e të bëhen shumë thashetheme me lista të veteranëve. Puna duhet të vazhdojë dhe kjo çështje të mbyllet njëherë e përgjithmonë", ka thënë Guçati.

Ai ka komentuar edhe deklaratën e kryeprokurorit

Aleksandër Lumezi, të ketë thënë se rreth 19 mijë veteranë kanë fituar statusin kundërligjshëm. "Edhe unë e lexova deklaratën e kryeprokurorit Lumezi. Tani nuk e di çfarë pret Lumezi dhe Prokuroria e Shtetit që nuk ndërmarrin diçka. Unë i bëj thirrje kryeprokurorit Lumezi t'i marrë të gjitha masat dhe të vazhdojë punën që i takon, nëse kanë prova që rreth 19 mijë veteranë fituan statusin kundërligjshëm", është shprehur Guçati.

Kryetari i OVL-UÇK-së ka treguar edhe për komunikimin që ka pasur me ish-prokurorin special Elez Blakaj para disa muajve. Sipas Guçatit, ish-prokurori që ka hetuar këtë çështje e ka pyetur nëse është në dijeni që janë fryrë listat e veteranëve të UÇK-së. "Unë jam kontaktuar një herë nga Elez Blakaj para dy-tre muajve. Ai më ka pyetur mua në cilësinë

e kryetarit të OVL-UÇK-së, se çka mendoj për fyerjen listës së veteranëve. Pra, krejt ajo që më ka pyetur është se a jam në dijeni se janë fryrë listat", ka thënë ai, duke treguar përgjigjen që ia ka dhënë ish-prokurorit. "Unë qëndrimin tim rreth kësaj çështje e kam bërë publik edhe më herët përmes medieve, ku kam thënë se listat e veteranëve janë të fryra dhe kërkojmë drejtësi", ka thënë Guçati. Sipas tij, Blakaj i ka treguar se për këtë çështje janë duke u bërë hetime dhe nuk ka thënë diçka nëse ndihet i kërcënuar nga dikush apo jo.

Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka deklaruar të enjten se janë rreth 19 mijë persona që jashtëligjshëm kanë fituar statusin e veteranit të luftës së UÇK-së dhe marrin përfitime nga shteti. "Në bazë të informacioneve që unë i kam, në fazën e hetimeve janë siguruar prova që vërtetojnë se 19 mijë veteranë të luftës kanë përfituar në mënyrë të kundërligjshme përfitime që ua ka dhënë Komisioni për Veteranë dhe Invalidë të Luftës", ka thënë Lumezi për "Radon Evropa e Lirë".

Ai ka sqaruar se prokurori që ka dhënë dorëheqje, Elez Blakaj, ka bërë një "draft-akuzë" ndaj disa personave për këtë rast dhe që i është dorëzuar prokurorit të Prokurorisë Speciale për sugjerime të tjera. "Ne ende nuk kemi aktakuzë zyrtare. Nëse një prokuror e

ngre një aktakuzë kundër disa personave, ajo duhet t'i dorëzohet gjykatës kompetente dhe duhet të dorëzohet në aq kopje sa ka të pandehur dhe sa ka avokatë mbrojtës dhe një kopje për nevojat e gjykatës. Në këtë rast ne kemi pasur vetëm një draft, të cilin prokurori e ka përgatitur dhe e ka dorëzuar në shikim të prokurorit të Prokurorisë Speciale, i cili sigurisht se, pas shikimit të atij drafti të aktakuzës, i ka dhënë sugjerime prokurorit Blakaj. Por, unë nuk kam informacione se çfarë sugjerimesh kanë qenë ato nga kryeprokurori dhe çfarë është vendosur më vonë në atë draftakuzë", është shprehur ai. Pas dorëheqjes së prokurorit që është marrë me çështjen e listës së veteranëve ka reaguar edhe ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se hetimi i keqpërdoruesve të listave të veteranëve të UÇK-së do ta rikthente dinjitetin e plotë të veteranëve të vulosur nga historia. "Së pari, shoqëria jonë është falënderuese për secilin veteran që në kohët më të vështira të historisë së popullit tonë ishin në krye të detyrës për mbrojtjen dhe çlirimin e Kosovës. Mijëra nga ta kanë lënë gjymtyrët në vijat e frontit dhe kjo meriton njohje, respekt dhe dinjitet të paçmim. Së dyti, shoqëria jonë është përcaktuar për të qenë shoqëri korrekte dhe e drejtë, përmes aspiratës për një shtet ligjor, si shëmbëll-

tyrë se si ndërtohet një shoqëri bashkëkohore dhe demokratike", ka shkruar ai, duke shtuar se kur jemi të shteti ligjor, kompromiset janë shprehur në gjuhën e ligjit dhe askund tjetër përveçse në ligj. "Hetimi për keqpërdorimin e listave të numrit të veteranëve nuk duhet parë nga asnjë perspektivë tjetër, përveçse perspektivës ligjore. Nëse ka pasur keqpërdorime, keqpërdoruesit duhet të identifikohen dhe ta marrin dënimin e përcaktuar me ligj. Procesi, si i tillë, nuk e zhbën meritën e askujt, përveçse materializon aspiratën tonë shoqërore e shtetërore për një republikë të denjë në të cilën çdokujt i njihet ajo çfarë i takon dhe çdokush e merr dënimin për abuzimin e meritës", ka shkruar Tahiri.

Ish-prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Elez Blakaj, i cili ishte duke hetuar dyshimet për keqpërdorime në listat e veteranëve të UÇK-së, ka dhënë dorëheqje të mërkurën. Ndonëse nuk është konfirmuar zyrtarisht, Blakaj thuhet të ketë dhënë dorëheqje për shkak të kërcënimeve për punën e tij. Ndërsa në një letër falënderimi që Blakaj ua kishte dërguar kolegëve të vet, ai kishte treguar se nuk ka pasur kërcënime, por karrierën do ta vazhdojë jashtë dhe brenda Kosovës, por jo më si pjesë e sistemit prokurorial.

Flet për "Epokën e re", Afrim Hoti

# Korrigjimi i kufirit s'mund të bëhet



Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti, e ka quajtur paradoksale që në këto rrethana të flitet për korrigjim të kufirit Kosovë - Serbi. Ai ka thënë se është i pamundur korrigjimi i kufirit për faktin se të dy shtetet nuk e njohin njëri-tjetrin dhe nuk kanë raporte të konsoliduara e as komunikim diplomatik. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoti ka deklaruar se ideja për korrigjimin e kufirit me Serbinë është e pazbatueshme meqë nuk përkrahet nga vendet e fuqishme. Ai ka vlerësuar se Kosova duhet të jetë pjesë e dialogut, por në asnjë mënyrë të bëjë koncesione të cilat do të bartnin rrezikshmëri për funksionalitetin e shtetit

deklaruar Hoti. Ai ka thënë se Kosova duhet të jetë pjesë e dialogut, por në asnjë mënyrë të bëjë koncesione të cilat do të bartnin rrezikshmëri për funksionalitetin e shtetit. Në këtë kontekst, sipas Hotit, më e rëndësishme është se çfarë flitet dhe çfarë vendimesh merren në kuadër të dialogut se sa kush e udhëheq këtë proces. Ai ka theksuar se Kosova e ka obligim ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe sikur që ka obligim t'i zbatojë në përpikëri rekomandimet e dhëna nga Gjykata Kushtetuese dhe, sipas Hotit, ky Asociacion nuk guxon të bjerë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe nuk mund të ketë as një lloj kompetence ekzekutive. "Kjo kompetencë do t'i mbante përfundimisht serbët e Kosovës të izoluar dhe shtetin e Kosovës në masë të madhe do ta bënte jofunksional", është shprehur ai.

**"Epoka e re":** Z. Hoti, në aspektin e marrëdhënieve ndërkombëtare si e keni parë idenë për korrigjimin e kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë?

**Hoti:** Çështja e përcaktimit të kufirit në mes të dy shteteve sovraane kalon nëpër tri faza. Faza e parë njihet me termin demilita-

cion, që nënkupton shënimin e tyre nëpër dokumente zyrtare, përfshirë këtu harta, skica të ndryshme dhe përshkrime narrative të vijës kufitare. Faza e dytë e shënimit të kufirit njihet me emrin demarkacion, që nënkupton tërheqjen e vijës kufitare bazuar në atë që është bërë në narracion ose në fazën e parë të demilitimit. Faza e tretë njihet me termin rektifikacion, që nënkupton korrigjimin e kufirit kur dy shtete bien në ujdë se shënimi i vijës kufitare nuk është bërë sipas parametrevave të duhur dhe i njëjti duhet të korrigjohet. Prandaj mbi logjikën apo konceptin teknik-teorik kjo është e mundur dhe kjo është praktikë e njohur në të drejtën ndërkombëtare. Kurse mbi konceptin praktik është jashtëzakonisht problematike të bëhet një gjë e tillë me Republikën e Serbisë për faktin se të dy shtetet nuk komunikojnë me njëri-tjetrin, nuk e njohin njëri-tjetrin në kontekstin ndërkombëtar dhe nuk kanë raporte të konsoliduara e as komunikim diplomatik. Është shumë e komplikuar për faktin se njëri shtet flet për korrigjim të kufijve ndërkombëtarë, kurse tjetër për mungesën e ekzistencës së tërësishme të kufirit.

**"Epoka e re":** Në rrethanat aktuale është e pamundur të bëhet korrigjimi i kufirit me Serbinë?

**Hoti:** Në këto rrethana është paradoksale të flitet për korrigjim të kufirit nëse paraprakisht nuk kemi njohje dhe komunikim normal në mes të shteteve. Në kuptimin praktik, nëse shtetet nuk e njohin njëri-tjetrin dhe nëse njëri e mohon ekzistencën e tjetrit, është paradoksale të flitet për kufijtë ndërkombëtarë, madje mos të flasim për korrigjimin e tyre.

**"Epoka e re":** Si i komentoni reagimet e vendeve të fuqishme lidhur me mundësinë e korrigjimit të kufijve në Ballkanin Perëndimor?

**Hoti:** Nuk kam dëgjuar asnjë element të ri në këtë drejtim. Fuqitë e mëdha i kanë ripërsëritur qëndrimet e tyre që i kanë dhënë nga vitet e '90-ta kur ka filluar shpërbërja e Jugosllavisë nga opinioni juridik i Badinterit, që shtetet e reja të lindin në kufijtë aktualë. Po ashtu, kam dëgjuar të njëjtat qëndrime që janë dhënë nga grupi i kontaktit në vigjilje të zgjidhjes së statusit të Kosovës duke proklamuar se nuk duhet të ketë ndryshim të kufijve, nuk

**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 16 GUSHT** - Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti, ka thënë të enjten se në rrethanat aktuale është paradoksale të flitet për korrigjimin e kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se ideja për korrigjimin e kufirit me Serbinë është e pazbatueshme meqë nuk përkrahet nga vendet e fuqishme. "Në kuptimin praktik, nëse shtetet nuk e njohin njëri-

tjetrin dhe nëse njëri e mohon ekzistencën e tjetrit, është paradoksale të flitet për kufijtë ndërkombëtarë, madje mos të flasim për korrigjimin e tyre. Korrigjimi i kufirit nuk mund të bëhet pa mbështetjen e fuqive të mëdha. Nëse ShBA-jë, Gjermania dhe vendet e tjera të fuqishme e kundërshtojnë këtë atëherë e tëra që ngelet në këtë drejtim janë vetëm deklaratat dhe konsumi medial i këtyre ditëve. Kur kësaj i shtohet fakti se të dyja shtetet nuk komunikojnë normalisht me njëri-tjetrin, atëherë kjo bëhet absolutisht e pazbatueshme", ka

# pa mbështetjen e fuqive të mëdha

parë i cili nuk lë hapësirë për të kaluar në hapin e dytë që është rrezikimi i raporteve të Kosovës me vendet e tjera. Vendet e fuqishme nuk e mbështesin idenë për ndryshimin e kufijve, prandaj duhet t'i kthehemi diskursit të deritashëm politik se Republika e Kosovës duhet të nënshkruajë marrëveshje paqeje me Serbinë në kufijtë aktualë dhe të njohur ndërkombëtarisht.

**"Epoka e re":** Në opinion sikur ka pasur një lloj frike se çështja e korigjimit të kufirit ka për qëllim ta lërë në hije çështjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, përkatësisht kompetencat e tij ekzekutive.

**Hoti:** Këto janë tematika të ndara. Korigjimi është çështje e ndarë nga ajo që njihet si asociacion. Çështja e korigjimit të kufirit është e pazbatueshme. Kurse çështja e asociacionit është obligim juridik ndërkombëtar që ka marrë Kosova me nënshkrimin e marrëveshjes së prillit të vitit 2013. Mbi këtë bazë Kosova e ka obligim ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe sikur që ka obligim t'i zbatojë në përpikëri rekomandimet e dhëna nga Gjykata Kushtetuese dhe ky asociacion nuk bën të bie në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe nuk mund të ketë asnjë lloj kompetence ekzekutive, e cila do të mbante përfundimisht serbët e Kosovës të izoluar dhe shtetin e Kosovës në masë të madhe do ta bënte jofunksional.

**"Epoka e re":** Pas gjithë këtyre zhvillimeve, si e shihni vazhdimin e procesit të dialogut Kosovë - Serbi?

**Hoti:** Procesi i dialogut duhet të vazhdojë, duhet të ndiqet trendi i bazuar fund e krye në interesat nacionale. Kosova nuk duhet të bëjë kompromise të reja sepse kompromiset e deritashme janë tregues shumë i qartë se Kosova ka zbatuar standardet më të larta për respektimin e të drejtave të komuniteteve. Kosova duhet të jetë pjesë e dialogut, por në asnjë mënyrë të bëjë koncesione të tjera të cilat do të bartnin rrezikshmëri për funksionalitetin e shtetit. Të gjitha këto tematika dhe këto tensione që janë ngritur gjatë verës duhet të mbesin në nivelin e deklarimeve politike, kurse ecja më tutje duhet të bëhet mbi strukturën dhe kornizën kushtetuese që kemi aktualisht.

**"Epoka e re":** Ndonëse është paralajmëruar se në shtator do të ketë një dinamikë të re të dialogut, në Kosovë ende nuk është arritur konsensusi për vazhdimin e këtij procesi.

**Hoti:** Mungesa e konsensusit politik në Kosovë është për keqardhje. Kjo nuk është diçka e

re sepse pothuajse asnjëherë për çaste të ndjeshme nuk kemi pasur konsensus. Megjithatë, konsensusi më i madh i të gjitha partive në pushtet dhe atyre opozitare është Kushtetua e Republikës së Kosovës. Çdo gjë që

bëhet në kuadër të respektimit të Kushtetutës dhe të rendit do ta ketë përkrahjen e njërit, respektivisht të këndit tjetër. Idetë e tjera të cilat kanë sjellë divergjenca pozitive-opozitive, madje edhe pakënaqësi te miqtë ndërkombëtarë,

përfundimisht duhet të braktisen. Nuk është shumë i rëndësishëm fakti se kush e udhëheq procesin e dialogut me Serbinë, mirëpo ka shumë rëndësi se çfarë bisedohet dhe çfarë vendime merren në këtë proces.

## Gjermania përsërit se kufijtë nuk ndryshojnë

**PRISHTINË, 16 GUSHT (ER)** - Ambasadori gjerman në Kosovë, Christian Heldt, ka ripërsëritur qëndrimin gjerman se shteti i tij nuk e përkrah idenë e ndryshimit të kufijve. Ai ka thënë se jeta e njerëzve nuk përmirësohet duke ndryshuar kufijtë. "Jam shumë i lumtur që kancelarja Merkel ishte shumë e qatë në këtë temë. Mos të harrojmë se këtë vit ne do ta rikujtojmë 100-vjetorin e përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Mendoj se ky kontinent ka parë mjaft probleme me kufij në shekullin e kaluar", ka thënë Heldt pas një takimi që ka pasur me ministrin e Ekonomisë së Kosovës, Bedri Hamza. Ai ka bërë thirrje për përmirësim të kushteve të jetesës së qytetarëve. "Le të fillojmë t'i përmirësojmë kushtet e jetesës së njerëzve për të gjitha komunitetet ku jetojnë në shtetet e tyre dhe jo t'i zgjidhim problemet me ndryshime të kufijve. Mendoj se këto kohë kanë përfunduar njëherë e përgjithmonë", është shprehur ai.

Komentet e ambasadorit Heldt vijnë pas prezantimit të idesë së presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, se ai është pro korigjimit të kufijve me Serbinë, ashtu që Prishtina t'i marrë komunat shqiptare të Luginës së Preshevës. Edhe zyrtarë në Serbi kanë thënë se duan ta marrin pjesën veriore të Kosovës dhe t'ia bashkojnë Serbisë. Një ide e tillë është kundërshtuar nga Gjermania dhe nga Britania e Madhe. Një ditë më parë, në një intervistë për gazetën "Epoka e re", presidenti Hashim Thaçi ka theksuar se deklarata e kancelares Merkel për mosndryshim kufijsh është një qëndrim i munguar për kohë të gjatë për Ballkanin Perëndimor. "Të gjithë jemi kundër ndarjes dhe shkëmbimit të territoreve. Gjithashtu, duhet të punojmë fuqishëm që në asnjë rrethanë të mos krijohet ndonjë situatë e krijimit të ndonjë autonomie serbe apo të ndonjë modeli të Srpska Republikës. Ideja ime për korigjimin e kufirit është ide për demarkimin e rreth 400 kilo-

metrave kufij në mes të shtetit të Kosovës dhe Serbisë. Kjo gjë do të ndodhë herët apo vonë. Derisa nuk ndodh demarkimi i kufirit Kosovë - Serbi, as Kosova nuk do të mund të lëvizë drejt NATO-s dhe BE-së, por as Serbia nuk do të mund të lëvizë drejt perspektivës evropiane. Tani kur BE-ja po modernizohet dhe reformohet, është kërkesë e qartë e lidershit evropian se asnjë vend i Ballkanit Perëndimor me probleme të së kaluarës nuk do të mund të jetë pjesë e familjes evropiane pa i tejkaluar ato probleme. Mundësia e arritjes së marrëveshjes Kosovë - Serbi, që nënkupton edhe përfshirjen e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës me Kosovën, është minimale, por tani është kërkesë e institucionalizuar nga liderët e Luginës së Preshevës të cilën do ta prezantoj në tryezë në Bruksel. E di se do të jetë një reagim jo i lehtë nga ana e autoriteteve të Serbisë, mirëpo këtë e ndiej si obligim moral, historik, kombëtar, politik dhe shtetëror", ka thënë presidenti Thaçi



duhet të ketë bashkim të shtetit, as kthim në situatën para vitit 1999. Mbi këtë bazë kemi një konsistencë nga fuqitë e mëdha sepse është fakt i ditur se nëse fillohet me ndryshimin e kufijve nuk flasim vetëm për kufirin Kosovë - Serbi, por edhe për kufijtë e tjerë të komplikuar, fundi i të cilëve është vështirë të parashikohet.

**"Epoka e re":** Kjo çështje do t'i rrezikonte marrëdhëniet e Kosovës me vendet e tjera?

**Hoti:** Korigjimi i kufirit nuk mund të bëhet pa mbështetjen e fuqive të mëdha. Nëse ShBA-ja, Gjermania dhe vende të tjera të fuqishme e kundërshtojnë këtë atëherë e tëra që ngelet në këtë drejtim janë vetëm deklaratat dhe konsumi medial i këtyre ditëve. Kur kësaj i shtohet fakti se të dyja shtetet nuk komunikojnë normalisht me njëri-tjetrin atëherë kjo bëhet absolutisht e pazbatueshme. Ndryshimi dhe përmirësimi i kufijve nuk do të ndodhë nëse nuk kemi qëndrim mbështetës të fuqive të mëdha. Prandaj e gjithë kjo do të mbetet vetëm në nivelin e deklaratave. Nuk ka zbatim të këtyre qëndrimeve nëse nuk ka mbështetje ndërkombëtare dhe ky është hapi i

# Suhareka, në gjendje të rëndë pas vërshimeve

Të mërkurën në mbrëmje Komuna e Suharekës me fshatra përreth është përfshirë nga një mot i lig i përcjell me të reshura të mëdha shiu. Si pasojë e vërshimeve janë dëmtuar shumë rrugë, shtëpi banimi dhe objekte të institucioneve të ndryshme. Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se janë shkaktuar dëme të mëdha materiale. Kryeministri Ramush Haradinaj ka premtuar përkrahjen e Qeverisë pas vërshimeve në Suharekë



EPOKA E RE

Arbisa SHEFKIU

**SUHAREKË, 16 GUSHT** - Dëmet nga reshjet e shiut që ndodhën të mërkurën në mbrëmje në Komunën e Suharekës janë të mëdha. Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka folur pas vërshimeve, duke e vlerësuar alarmante këtë situatë. Ai ka bërë me dije se janë dëmtuar nga uji shumë rrugë, shtëpi banimi dhe objekte të institucioneve të ndryshme. Gjatë një konference për medie mbajtur të enjten, Muharremaj ka treguar se si pasojë e vërshimeve janë shkaktuar dëme të mëdha materiale. "Jemi vazhdimisht në terren që nga mbrëmje kur kanë filluar reshjet dhe kemi formuar komisionet për sanimin e situatës ku të

gjithë qytetarëve që janë dëmtuar do t'u dalim në ndihmë në forma të ndryshme", ka thënë ai. Muharremaj ka treguar se pas vërshimeve ka mbledhur Shtabin Emergjent për ta vëzhguar situatën e krijuar në terren. "Janë formuar tri komisione të cilat do të dalin në terren për të parë se si është gjendja dhe do ta bëjnë regjistrimin e tyre dhe vlerësimin e dëmeve", ka thënë Muharremaj, duke shtuar se qyteti është bllokuar nga uji, ndërkohë në shumë fshatra ka dëme materiale.

## Qeveria mobilizohet për t'u dalë në ndihmë qytetarëve të Rahovecit

Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se me shqetësim ka marrë lajmin për vërshimet në

Suharekë. "Si kryeministër i vendit menjëherë kam kërkuar nga FSK-ja dhe Ministria e Punëve të Brendshme mobilizim dhe që t'i ndërmarrit të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për t'u dalë në ndihmë banorëve të kësaj ane. Po ashtu, jam në kontakt të vazhdueshëm me kryetarin e kësaj komune, z. Bali Muharremaj dhe po e përcjellim me vëmendje situatën e krijuar në Suharekë", ka bërë me dije

Haradinaj, duke shtuar se si Qeveri do ta bëjnë maksimumin që ta parandalojnë rrezikimin e jetëve të qytetarëve. "Do t'u

dalim në ndihmë banorëve që kanë pësuar nga kjo fatkeqësi natyrore", është shprehur kryeministri Haradinaj.

## Ahmeti: Kryetarët e komunave duhet t'i aktivizojnë shtabet e krizave

Tahir Ahmeti, njohës i çështjeve të emergjencave, njëherësh bashkëthemelues i Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë (SPRC), ka reaguuar për vërshimet në Suharekë. Ai ka thënë se çështja e përmbytjeve apo e vërshimeve, sidomos atyre të shpejta, është një dukuri e cila çdo ditë e më shumë është duke i goditur vendet e ndryshme të botës dhe të rajonit. "Siç po shihet, as vendi ynë nuk mund të ketë

përjashtim nga këto situata. Pas përmbytjeve, në vise të ndryshme të Kosovës (gjendje më e rëndë në Komunën e Suharekës), kryetarët e komunave, në bashkëpunim me agjencinë për menaxhimin e emergjencave (AME), duhet t'i vënë në dispozicion të gjitha resurset dhe t'i aktivizojnë shtabet e krizave, në mënyrë që t'i dilet në ndihmë popullatës së prekur nga këto përmbytje", ka thënë Ahmeti.



# ISPE paralajmëron kallëzim penal ndaj ministrit Bytyqi

**PRISHTINË, 16 GUSHT** - Kolegji ISPE ka publikuar letrën që do t'ia dërgojë Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR) dhe Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) në lidhje me mosakreditimin e disa programeve të këtij kolegji, për të cilat ky kolegji fajëson Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA).

Në një konferencë për media, profesori i këtij kolegji, Avni Mazrreku, paralajmëroi kallëzim penal që do t'i bëhet nga ISPE ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi. Ai ka theksuar se Ministria e Arsimit që nga viti 2014 e ka lënë

Agjencinë e Akreditimit pa një drejtor, por vetëm me ushtrues detyre. Sipas Avni Mazrrekut, deklaratat e AKA-së rreth ndërhyrjeve të ISPE-së në Agjencinë e Akreditimit nuk janë të vërteta. Ai tregoi që një pjesë e kallëzimit penal ndaj ministrit Bytyqi do të bëhet publike gjatë javës së ardhshme, kur edhe do ta dorëzojnë atë. "Ndërhyrjet që kanë thënë mediumet që ka bërë ISPE-ja nuk janë të vërteta. Një pjesë e kallëzimit penal ndaj ministrit të Arsimit, Shyqiri Bytyqi, do të bëhet publike. Letra me ankesat e këtij kolegji do t'i dërgohen ENQA-s dhe EQAR-it më 22 gusht, tha ish-drejtori i ISPE-së", Avni



Mazrreku.

Për pasojat me të cilat mund të përballet Kosova pas kësaj ankese, sipas Mazrrekut, duhet të japë përgjegjësi vetëm ministri Bytyqi. "Deri më 22 gusht është koha kur do të dërgohet letra. Kolegji ISPE nuk do të marrë përgjegjësi nëse Kosova përjashtohet plotësisht nga EQAR dhe ENQA si pasojë e letrës sonë. Përgjegjësia bie ekskluzivisht mbi ministrin e Arsimit nëse largohet Kosova", shtoi ai.

Ditë më parë, ministri Shyqiri Bytyqi akuzoi Kolegjin ISPE për presion dhe shantazh ndaj Ministrisë dhe Agjencisë së Akreditimit.

## Arifi: Kosova nuk ka marrë obligim ta formojë Asociacionin si instrument të Serbisë



PRISHTINË, 16 GUSHT - Shefi i delegacionit të Kosovës në bisedimet teknike me Serbinë, Avni Arifi, ka thënë se Kosova ka marrë obligim ndërkombëtar për krijimin e Asociacionit të Komunave Serbe si formë e avancimit të pozitës së komunitetit serb në Kosovë. Përmes një postimi në llogarinë e

vet në "Facebook" Arifi ka shkruar se në këtë qëndrim Kosova vazhdon të kërkojë zgjidhje dhe ka konsensus të mjaftueshëm në shoqërinë e Kosovës për gjetjen e një zgjidhje gjithnjë duke ruajtur kushtetutshmërinë, tërësinë territoriale dhe funksionalitetin e shtetit. "Kosova kurrë nuk ka

marrë obligim të krijojë asociacion që do të shërbejë si instrument i shtetit serb për defunksionalizimin dhe kontrollimin e shtetit të Kosovës. Ideja që nëpërmjet asociacionit të depërtohet në funksionim të shtetit të Kosovës është perfide dhe nuk do të kalojë", ka shkruar Arifi.

## Liberalizimi i vizave, më 29 gusht pjesë e agjendës së Komitetit LIBE



Raportuesi i Parlamentit Evropian për Kosovën, Igor Sholtes, në një bisedë telefonike me ministren e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka bërë me dije se më 29 gusht do të mbahet takimi i Komitetit për të Drejtat Civile, Drejtësi dhe Çështje të Brendshme (LIBE), ku liberalizimi i vizave për Kosovën do të jetë në agjendë. Ai ka thënë se është optimist se ky proces do ta marrë dritën e gjelbër për të ecur tutje

EPOKA  
ERE

### Qendresa RAMA

PRISHTINË, 16 GUSHT - Ministrija e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka folur të enjten përmes telefonit me raportuesin e Parlamentit Evropian për Kosovën, Igor Sholtes, me të cilin ka diskutu-

ar për hapat e ardhshëm për procesin e liberalizimit të vizave, duke pasur parasysh faktin se tashmë i gjithë procesi është në duart e institucioneve të BE-së pas plotësimit të kriterëve nga ana e Kosovës. Ministrija Hoxha e ka informuar Sholtes se Kosova është duke vazhduar reformat dhe zbatimin e

MSA-së dhe ka kërkuar që procesi i vendimmarrjes sa i përket liberalizimit të vizave të përshpejtohet. Ajo ka theksuar se qytetarët e Kosovës e kanë të qartë se janë në prag të liberalizimit të vizave dhe po presin me padurim lëvizjen e lirë. Ministrija Hoxha e ka njoftuar raportuesin për Kosovën për

fushatën e vetëdijesimit për liberalizimin e vizave të cilën e ka filluar Ministria e Integritimit Evropian, me theks të veçantë informimin e qytetarëve sa i përket asaj se çfarë nënkupton liberalizimi i vizave si dhe sanksionet që mund të pasojnë në rast të keqpërdorimit.

Më tutje, ministrija Hoxha ofroi mbështetjen dhe bashkëpunimin e plotë të institucioneve të vendit në mënyrë që procesi i vendimmarrjes të jetë sa më i shpejtë dhe pritshmëritë e qytetarëve për lëvizjen e lirë deri në fund të vitit të plotësohen. Ndërsa raportuesi i Parlamentit Evropian për Kosovën,

Sholtes, e ka falënderuar ministren Hoxha për angazhimin e saj gjatë gjithë procesit, duke e siguruar se ka mbështetjen e plotë për ta përshpejtuar vendimmarrjen për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës.

Po ashtu, Sholtes e ka njoftuar ministren për hapat e ardhshëm, për takimin e Komitetit për të Drejtat Civile, Drejtësi dhe Çështje të Brendshme (LIBE) më 29 gusht, ku liberalizimi i vizave për Kosovën do të jetë në agjendë. Ai ka thënë se është optimist që ky proces do ta marrë dritën e gjelbër për të ecur tutje.

## IPK-ja: Në rastin e Valbona Markut s'kishte shkelje nga policia

PRISHTINË, 16 GUSHT - Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) me anë të një komunikate për media ka bërë me dije se në bazë të gjetjeve të tyre, del se pjesëtarët e policisë në Gjakovë kanë bërë

punën e tyre në rastin e Valbona Markut. Në komunikatë IPK-ja ka njoftuar për veprimet policore, të cilat janë ndërmarrë në ditën kur ndodhi vrasja e Valbona Markut dhe vajzës së

saj, në fshatin Brekoc të Komunës së Gjakovës. "Për të gjitha këto veprime të ndërmarrë nga zyrtarët policorë, të njëjtit kanë informuar po atë ditë prokuroren kujdestare të

Prokurorisë Themelore në Gjakovë, ku nga prokurorja kujdestare nuk është kërkuar ndonjë veprim shtesë lidhur me këtë rast", është bërë me dije nga Inspektorati Policor i Kosovës.



# Kosova dhe Shqipëria me kampanjë 'Blej shqip'

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 GUSHT - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka pritur të enjten në takim kryetarin e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Tiranë, Nikolin Jaka. Të pranishëm në takim ishin edhe përfaqësues të bizneseve të rëndësishme nga sektorë të ndryshëm të Kosovës. Ky takim paraqet qëndrimin e Odës Ekonomike të Kosovës dhe Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Tiranë për zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik në mes të Kosovës dhe Shqipërisë dhe lehtësimin e tregutit të produkteve në mes të dy vendeve.

Kryetari i Odës Ekonomike të

Kosovës, Berat Rukiqi, ka bërë me dije se një nga iniciativat e përmendura në këtë takim ishte organizimi i një kampanje afatgjatë dhe gjithëpërfshirëse "Blej shqip", si dhe krijimi i një strukture të përbashkët që do ta përmirësonte komunikimin në mes bizneseve të dy vendeve.

Ndërsa kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Tiranë, Nikolin Jaka, ka thënë se problemet ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë janë të shumta, por jo të pazgjidhshme. Ai ka thënë se së shpejti do të dalin me një platformë bashkëpunimi ku do të përfshihen kërkesat ndaj dy qeverive të vendeve përkatëse. Përpos kësaj, Nikolin ka shtuar se mbështetja për Odën Ekonomike të Kosovës do të jetë maksimale.



## Bizneset humbin miliona si pasojë e ndaljes së rrymës



PRISHTINË, 16 GUSHT - Bizneset prodhuese në Kosovë vazhdojnë të përballen me furnizim jo të rregullt me energji elektrike. Në vit, sipas hulumtimeve të bëra, humbjet ekonomike për shkak të furnizimit të pasigurt me energji elektrike thuhet se shkojnë deri në 300 milionë euro në vit. Disa prej bizneseve prodhuese kanë bërë investime vetjake, kryesisht kanë blerë gjeneratorë si dhe kanë bërë investime në ndërtimin e lartëpërçuesve për të pasur furnizim të rregullt me energji elektrike.

Sipas një hulumtimi të Odës Ekonomike të Kosovës, për një

vit kostot shtesë nga investimet që bizneset bëjnë për të pasur furnizim të rregullt me energji elektrike shkojnë deri në 300 milionë euro. Kompania "Pestova", e cila merret me përpunimin dhe prodhimin e patates, për t'iu shmangur mungesës së energjisë elektrike kohë më parë kishte ndërtuar një lartëpërçues. Pronari i kësaj kompanie, Bedri Kosumi, ka treguar për "Radion Evropë e Lirë" se të gjitha këto investime për të hyrë në kategorinë 'A plus', që nënkupton furnizim pa ndërprerje me energji elektrike, ka shpenzuar deri në 243 mijë euro. "Me këto investime të bëra

tani kemi furnizim të rregullt me energji elektrike. Ne jemi në kategorinë A plus dhe parapaguajmë 25 për qind të energjisë së harxhuar në vit, pra 25 për qind e parave janë të bllokuara. Nëse nuk do të ishim në këtë kategori do të ishte e pamundur të mendohet të punohet me furnizim jostabil me energji elektrike. Një ndërprerje e paparalajmëruar e energjisë shkakton dëme të mëdha të makinerisë me të cilën punohet", ka thënë Kosumi.

Kosova përgjatë viteve është duke u ballafaquar me furnizim jostabil me energji elektrike.

Ndërprerjet e kohëpaskohshme të energjisë elektrike paralajmërohen përmes njoftimeve zyrtare nga Distribucioni i Furnizimit me Energji Elektrike (KEDS). Aty tregohet për kohën dhe regjionet se kur do të ndërpritet energjia elektrike. Si arsye kryesore e mungesës së këtij produkti në Kosovë vazhdimisht theksohet vjetërsia e termocentraleve në Kosovë. "Termocentrali A" daton që nga vitet e '60-ta, ndërsa termocentrali "Kosova B" nga vitet '80-ta. Drejtori ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve të Kosovës, Astrit Panxha, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se kjo mungesë e

energjisë elektrike është një problem mjaft shqetësues për bizneset prodhuese. "Furnizimi jo i rregullt me energji elektrike dhe jokonsistenca në kualitetin e energjisë po shkakton probleme të mëdha te prodhuesit. Një raport që është publikuar nga USAID tregon se humbjet nga energjia elektrike për prodhuesit në Kosovë, që sillen rreth 300 milionë euro në vit, që nënkupton se nëse marrim parasysh eksportet tona, janë rreth 300 milionë euro, atëherë çdo euro që e ftojnë prodhuesit nga eksportet duhet ta shpenzojnë për ta mbuluar koston e humbjes nga energjia elektrike", ka thënë Panxha. Pasiguria me furnizim me energji elektrike, shton Panxha, është një nga kufizimet kyçe për zhvillimin e sektorit prodhues në Kosovë. "Mungesa e energjisë elektrike po shkakton probleme të mëdha edhe në konkurrueshmërinë e produkteve të Kosovës sepse me një kosto të lartë të energjisë elektrike nuk mund të jesh konkurrent në treg me produktet që vijnë nga rajoni apo Bashkimi Evropian", është shprehur Panxha.

Pas më shumë se një dekadë përgatitjesh në fund të vitit të kaluar Qeveria e Kosovës kishte arritur ta nënshkruajë marrëveshjen komerciale me kompaninë amerikane "Contour Global" për ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re". Ky termocentral thuhet se garanton pavarësi energjetike dhe siguri të vazhdueshme me energji elektrike. Termocentralit "Kosova e Re" parashikohet të vihet në punë në vitin 2023.



## Gjermania jep 6.5 milionë euro për krijimin e vendeve të punës në bujqësi



**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 16 GUSHT** - Qeveria e Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, e përfaqësuar nga ambasadori i Republikës Federale të Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, kanë nënshkruar marrëveshjen financiare të grantit për "Shërbime financiare për krijimin e vendeve të punës në sektorin e bujqësisë, fondi për garantimin e kredive III" në vlerë prej 6.5 milionë eurosh. Mjetet janë të dedikuara për sektorin e

bujqësisë.

Gjatës ceremonisë ministri Bedri Hamza ka falënderuar ambasadorin gjerman dhe taksapaguesit e këtij shteti për kontributin e vazhdueshëm për përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve të Kosovës. Për më tepër, ministri Hamza ka shtuar se kjo është marrëveshja e tetë që është nënshkruar me Qeverinë Gjermane që nga marrja e mandatit në shtator të vitit 2017. Ai ka thënë se që nga marrja e këtij mandati është zotuar për zhvillimin e sektorit privat në Kosovë, ku një prej instrumenteve është rritja e kapitalit të Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive.

Hamza ka pohuar se këto mjete janë donacion (para pa kthim) nga Qeveria Gjermane si mbështetje për zhvillimin e sektorit privat në Kosovë. Ai ka thënë se për këtë i janë shumë mirënjohës Qeverisë së Gjermanisë. "Shteti gjerman është një ndër donatorët më të mëdhenj për Kosovën dhe që nga viti 1999 përmes kontributit financiar dhe teknik është në Kosovë me shumën përmbi 500 milionë euro, prej të cilave më shumë se 80 për qind prej tyre janë grant. Ndërsa Fondi për Garantimin e Kredive vetëm nga Qeveria Gjermane deri më tani ka pranuar kontribut financiar apo para

falas në vlerë prej 14 milionë eurosh, që mundëson që sektori privat, përfshirë këtu të rinjtë dhe gratë, të kenë qasje më të lehtë në financimin e bizneseve të tyre dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Fondi për Garantimin e Kredive është një institucion i cili është themeluar dhe funksionalizuar falë bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe donatorëve", ka thënë Hamza, duke bërë me dije se me nënshkrimin edhe të kësaj marrëveshjeje, vlera totale e marrëveshjeve grant të nënshkruar me donatorë të ndryshëm që kur e ka marrë mandatin e ministrit ka arritur shumën 101 milionë

euro.

Ndërsa ambasadori gjerman në Kosovë, Christian Heldt, ka falënderuar ministrin Hamza për mirëbesimin dhe bashkëpunimin që kanë institucionet e të dyja shteteve, sidomos në fushën e bashkëpunimit ekonomik dhe financiar, duke thënë se kjo ndihmesë është që Kosova të jetë sa më afër integriteteve euroatlantike. Ambasadori Heldt ka pohuar se donatorë të rinj kanë shprehur interesimin të kontribuojnë në Fondin për Garantimin e Kredive me qëllim të krijimit të vendeve të reja të punës dhe një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik në Kosovë.

## Posta e Kosovës, 45 për qind më pak dërgesa postare në vitin 2017

**PRISHTINË, 16 GUSHT** - Gjatë vitit të kaluar janë realizuar 4,5 milionë dërgesa postare, apo rreth 40 për qind më pak se në vitin 2016. Nga kjo rënie e dërgesave më së shumti ka pësuar Posta e Kosovës, e cila kishte rënie të dërgesave në vitin 2017 për rreth 45 për qind më pak se në vitin paraprak, ndërsa operatorët postarë privatë kishin një dyfishim të dërgesave. Kjo rënie

drastike e punës së kësaj ndërmarrjeje publike është pasqyruar në raportin e Autoritetit Regullativ për Komunikimet Elektronike dhe Postare (ARKEP).

Rënia e dërgesave në Postën e Kosovës nuk ishte në proporcion me rënie të hyrave pasi, sipas ARKEP-së, rënia e të hyrave të Postës nga ky shërbim ishte vetëm 6 për qind, ka raportuar

"Kallxo.com". Në pasqyrën e përgjithshme të tregut të shërbimeve postare për vitin 2017 tregohet se qytetarët e Kosovës kanë pakësuar blerjen e shërbimeve postare që përfshin dërgesa postare në letra dhe pako.

ARKEP-ja në raportin vjetor ka konstatuar se për 12 muaj kishte rënie prej 39 përqindësh të dërgesave postare në përgjithësi.




## Muhaxheri e Gashi diskutuan për sfidat e sigurisë në Komunën e Pejës

PRISHTINË, 16 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxhiri, ka takuar të enjten ministrin e Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, me të cilin ka diskutuar lidhur me çështjen e sigurisë në Komunën e Pejës.

Kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxhiri, e ka njoftuar ministrin Gashi lidhur me sfidat me të cilat ballafaqohet kjo komunë sa i përket situatës së sigurisë dhe për çështjet me të

cilat do të mund të mbështetet niveli komunal nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Në këtë takim u diskutua edhe për përmirësimin e shërbimeve të gjendjes civile, në kuadër të sistemit të unifikuar të gjendjes civile, sistem ky që u lehtëson qytetarëve pasjen me dokumente. Ministri Gashi ka theksuar se bashkëpunimi mes nivelit qendror dhe atij lokal është shumë i rëndësishëm në shërbim të qytetarëve.



## Prishtina do t'i ketë edhe pesë shkolla të reja

Prishtinë, 16 gusht (ER) - Kryeqyteti i Kosovës, në bashkëpunim me IFC të Bankës Botërore, është duke punuar në realizimin e konceptit të Private Finance Initiative (PFI) për ndërtimin e pesë shkollave në Prishtinë. IFC përmes konkursit të hapur ka përzgjedhur kompaninë që do të përpilojë koncept-dizajnin e shkollave. Këtë konkurs e ka fituar konsorciumi "Mazzanti", me përvojë shumëvjeçare në dizajnimin e objekteve

arsimore nëpër botë.

Ideja është që struktura e shkollave të jetë e hapur dhe e gatshme për t'iu përshtatur kërkesave që mund të vijnë në të ardhmen, duke e lënë mundësinë për anekse varësisht nevojës. Secili nga modulet do të jetë fleksibil për ndryshime brenda të njëjtit lokacion. Deri më tani janë përzgjedhur lokacionet në Mat, Sofali, Veternik dhe Arbëri, kurse në Kalabri jemi në proces e sipër. Ekipi i IFC-së është duke e bërë

studimin e fizibilitetit dhe duke e përpiluar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, ashtu që t'i dërgojë sa më parë në njësinë e Partneritetit Publiko-Privat (PPP) për ta dorëzuar tutje në komitetin e PPP-së.

Ndërtimi i këtyre pesë shkollave, në të njëjtën kohë, do ta ulë dukshëm numrin e nxënësve në shkollat e mbingarkuara dhe, si rrjedhojë, do të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së arsimit në kryeqytet.



## Haziri: Llashtica, fshat model i punimit të tokës bujqësore

GJILAN, 16 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, gjatë qëndrimit në fshatin Llashticë ka thënë se ky fshat është model i bashkëpunimit. Haziri ka kërkuar nga Këshilli i këtij fshati që së bashku me Shoqatën e Bashkatdhetarëve të fillojnë t'i mirëmbajnë projektet e investuara. "Investimet ne tash i bartim te qytetarët dhe bashkatdhetarët

tanë kudo që po angazhohen po sjellin model të ri, edhe të mirëmbajtjes, edhe menaxhimit, edhe të kujdesit. Me pak mjete të tyre, bëhet shumë punë në këtë fshat", ka thënë Haziri, duke bërë me dije se vitin e ardhshëm do të përfundojnë të gjitha projektet investive në këtë fshat, përfshirë edhe në aspektin e bujqësisë dhe të infrastrukturës.

Ndërsa kryetari i Këshillit të fshatit Llashticë, Ekrem Hasani, ka falënderuar kryetarin Haziri për mbështetjen e madhe për realizimin e projekteve. Pas vizitës së projekteve të ndryshme, kryetari i Gjilanit me bashkëpunëtorë kanë bërë homazhe te varrezat e martirëve duke ritheksuar se "Llashtica është Reçaku i Anamoravës".

## Arrestohet një polic për dhunë në familje

PRISHTINË, 16 GUSHT (ER) - Policia e Kosovës ka arrestuar një zyrtar policor, nën dyshimin se ka ushtruar dhunë në familje. Siç ka njoftuar Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) përmes një komunikate për media, hetuesit e Departamentit të Hetimeve kanë kontaktuar me

viktimën e këtij rasti dhe pas verifikimit të informacioneve, është dërguar për trajtim mjekësor, ndërsa ndaj zyrtarit të dyshuar është shqiptuar masa e ndalimit prej 48-orësh. IPK-ja i ka rekomanduar Policisë së Kosovës masën e suspendimit ndaj zyrtarit policor të arrestuar.



# KRERËT E OKTAPODIT DHE PESHKAQENI I MADH



**Bedri ISLAMI**

Drejtësia e shtetit shqiptar është, të paktën deri tani, një lëmsh i madh, i zjarrtë që ka djegur shumëçka në këtë vend dhe çdo gjë që del tashmë zbuluar nuk është vetëm maja e asaj që është ditur prej kohësh dhe që ka pjesën e saj në rënien poshtë të shtetit.

I gjithë ky sistem, i kalbur deri në rrënjë dhe armik i pamëshirshëm i vendit të tyre, ka pasur deri më tani një kupolë institucionale, e cila quhet Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Në krye të këtij Këshilli, në kohë të ndryshme ka pasur presidentë, të cilët, duke u bërë palë me rrëshqitjet fatale, nuk do të thotë se sot duhen ta ndiejnë veten të larë dhe sikur të mos kishte ndodhur asgjë në kohën e tyre.

Kupola e drejtësisë, e cila të ngjan më shumë me krerët e oktapodit, prej shumë viteve e kishte mbajtur sistemin gjykues në duart e veta, të cilat nuk mund të pastrohen thjesht përmes Vettingu pasi, jo pak herë, nga vendimet e tyre kanë rrjedhur edhe lumenj gjaku, sidomos kur kanë mbështetur, promovuar dhe sistemuar në vendet e tyre të preferuara njerëz me moral qytetar të dyshimtë, kur përmes lojës së tyre kanë bërë politikën e pistë të shembjes së shtetit dhe, në vend që të jetë një nga shtyllat e mbajtjes së vendit, u kthyen në gërmuesit e mjerimit të vendit. Sido që të ketë ndodhur, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me përjashtime sporadike, do të mbahet mend si gangrena e gjyqësorit shqiptar, si vendi ku janë bërë allishverishet më flagrante dhe që në vitet e fundit,

nën presidencën Nishani - Berisha, u bënë turpi i skajshëm i ligjit dhe i rendit. Asnjëherë më parë, në asnjë rrethanë, nuk ka pasur dhe, për fat, nuk do të mund të ketë një Këshill të tij të Drejtësisë, i cili, me dashje, skajshëm i skanuar politikisht, rrënoi pushtetin për ta ngritur mirëqenien e tyre; shkatërruan jetë njerëzore që fëmijët e tyre të hallakateshin nëpër rrugët e Evropës; grabitën prona dhe dhanë vendime të turpshme për t'i ngritur vilat dhe godinat e tyre, herë të ditura dhe më shumë të paditura.

Në pesë vjetët e fundit Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Nishani, si drejtuesi i tij, jo vetëm u bënë shembulli i turpshëm i jetës gjyqësore, por e shndërruan veten në një trupë që plotësonte urdhrat e dhënë nga familja Berisha, duke vendosur aty ku familja dëshironte, njerëz besnikë të një klase politike, thellësisht të çoroditur dhe skajshmërisht antikomb; duke caktuar besnikërisht njerëz të devotshëm për të shërbyer me zell, edhe pse shteti, institucionet e tjera, bënë një pjesë të punës së tyre duke dërguar për shqyrtim raste, gjyqtarë dhe figura që ishin degraduar në mënyrën më marramendëse të mundur. Krerët e këtij oktapodi kishin mbi vete peshkaqenin Berishë, i cili, duke luajtur me të dhënat e tyre, duke ia ditur burgjitë dhe pasurinë, duke pasur dije ndoshta për secilin, i bindur se kishte para vetes njerëz jodinjtozë, të gatshëm për të shërbyer, skllëvër të politikës dhe moralisht të shkatërruar, i tërhiqte fijet dhe ua tundte kokat sipas dëshirës, duke ua ngritur dorën si të kishte dëshirë ai vetë, apo thjesht njerëzit e familjes së tij.

Avokatët e Berishës, të afërmit e Shkëlzen Berishës, të njohurit dhe bashkëpunuesit e Argitës, skllëvërit juridikë të Bashës u bënë gjyqtarë të Apelit, u

deleguan në Gjykatën e Lartë, vajtën në Gjykatën Kushtetuese. Ata ishin deri në fund krerët që i tundeshin oktapodit të drejtësisë dhe që, kur kishin dëshirë, lëshonin tymin e politikës gjyqësore dhe grabitnin gjithçka mundnin, të bindur se pushteti i toleronte dhe nuk dëshmonte.

Ndoshta ata janë ndër njerëzit më të pasur në sistemin e drejtësisë. Pasuria e tyre e për-bashkët, e njohura dhe jo me gjithë të panjohurën, shkon deri në 8 miliardë lekë të rinj dhe askush nuk e di dhe as nuk mund ta marrë me mend se çfarë fshihet pas pjesës së dukshme.

Shumë nga ata që u rrëzuan nga Vettingu apo që iu shmangën atij, duke hequr dorë nga karriera e tyre juridike, ishin pikërisht të vendosurit në postet e shpërblimit. Le të sjellim disa shembuj:

Mirela Fana ishte anëtare e Gjykatës së Lartë. E emëruar nga parlamenti, me mbështetjen e Partisë Demokratike, me vendimin nr. 248, datë 23.04.2009. Është bashkëshortja e Neshat Fanës, avokati i njohur i familjes Berisha. U tërhoq nga profesioni sapo u miratua ligji për reformimin e sistemit të drejtësisë.

Besnik Ymeri, ish-anëtar i Gjykatës Kushtetuese, u largua me dëshirë të imponuar nga sistemi, pasi, nëse nuk do të ishte Vettingu, do të ishte përsëri aty. Është propozuar nga Bujar Nishani dhe miratuar shpejt e shpejt më 22 mars 2013.

Nga Gjykata Kushtetuese, largohet edhe Altina Xhoxhaj, e propozuar dhe e miratuar nga PD-ja në vitin 2010.

Shtatë juristët e përzgjedhur në vitin 2012, disa në pragun e largimit nga pushteti, ishin njerëz të gardës berishiane: ata u emëruan në Gjykatën e Apelit, në Gjykatën e Lartë apo në atë Kushtetuese, pasi kishin dhënë prova të larta besnikërie

në gjyqe të "patates së nxehtë", të Gërdecit, të 21 janarit, ndaj Damir Fazliçit etj., si Fatmira Hajdari, Shkëlqim Mustafa, Tom Ndreca, Fatos Lulo e mes tyre edhe i njohuri gjykatës shërbyes i lartë politik, Agim Bendo, që mes të tjerave njihet edhe për marrjen në mbrojtje të një perversi politik ministër. Tom Ndreca është emër i njohur me vendimet e tij abstrakte, por thellësisht politike. Tani është jashtë sistemit. U emërua si anëtar i Gjykatës së Lartë në prill të vitit 2013 nga ish presidenti Nishani dhe u miratua me procedurë të shpejtë nga grupi parlamentar i PD-së. A mundej vallë që gjyqtari, i cili mbylli dosjen e 21 janarit, të mos gradohej e shpërblehej? Fatos Lulo u emërua nga PD, fillimisht në Gjykatën e Lartë, në vitin 2005 dhe pastaj, i propozuar nga Nishani, në maj të vitit 2013 kaloi në Gjykatën Kushtetuese.

Admir Thanza, ishte anëtar i Gjykatës së Lartë, i emëruar po nga e njëjta strukturë dhe i marrë në mbrojtje nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Sot jashtë sistemit, për shkak të lidhjeve me krimin, vjedhjes dhe dënimit në Itali dhe fshehjes së saj. Propozuar nga Bujar Nishani, votimi i tij, me procedurë të shpejtuar, është mundësuar nga Berisha dhe Topalli.

Gani Dizdari, po ashtu, propozohet nga Bujar Nishani si anëtar i Gjykatës Kushtetuese dhe miratohet me procedurë të shpejtuar. Jashtë sistemit aktualisht.

Juristi Metalla u emërua në Gjykatën e Apelit të Tiranës në vitin 2013, në pragun e ndërrimit të pushtetit dhe, po ashtu, i mbështetur nga Partia Demokratike.

Më shumë se tre të katërtat e të larguarve nga sistemi janë emërimet të "peshkaqenit të madh" dhe kreut të oktapodit të rrezikshëm.

A nuk mban përgjegjësi struk-

tura që i propozoi dhe i emëroi shpejt e shpejt të larguarit e sotëm nga sistemi i drejtësisë, si Fatmir Hoxha i larguar nga Gjykata Kushtetuese, ku ishte deleguar në vitin 2011, Artan Zeneli, po ashtu, në vitin 2012, Artan Lacaj njëjtë, Gentian Trenova. Rovena Gashi, krahu i djathtë e shefit të prokurorisë, sozia e frikshme e tij, u emërua në atë post në vitin 2013, etj. Shembujt janë të shumtë.

Krye shembulli është ai i ish kryeprokurorit të përgjithshëm, Llalla. Pas propozimit të Bamir Topit, që ishte ende në marrëdhënie të mira dhe të ngrira njëkohësisht me PD-në, Adriatik Llalla, pas provave që kishte dhënë duke mbuluar pasuritë abuzive, në vendin ku ishte caktuar, me 75 votat e PD-së dhe të LSI-së, zgjedhet kryeprokuror.

Qëndroi për pesë vite dhe për hatër të tij desh dogjën parlamentin dhe deshën t'i venë flakën gjithë vendit. Të zgjedhurin e tyre, si mburojë ndaj drejtësisë, u përpoqën ta mbanin me gjithë forcat e tyre dhe, jo rastësisht, përsëri ata që e ngritën, ata desh edhe dogjën gjithçka për hirin e tij: PD dhe LSI.

Një mik i imi, njohës i shkëlqyer i sistemit të drejtësisë, pas një shkrimi më dërgonte mesazhin e mëposhtëm: "Pjesë e Vettingu duhet të jenë domosdo anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ata duhet të japin llogari për vendimarrjen e tyre, thellësisht abuzive, por edhe për transferimet. Koha e Nishanit ishte në fakt koha e listave që dërgonte Berisha dhe familja e tij. Bënë karrierë gratë e burrat e anëtarëve të KLD dhe u pasuruan marramendshëm shpejt. U rikthyen në gjyqësorë ish kursantë që ishin vetëlarguar apo i kishin larguar nga drejtësia". Një sistem i kapur nuk mund të largohet nëse nuk i shkund mirë e mirë ato që duhen shkundur.

## Bekim Jashari pret në takim drejtorin e Akademisë Diplomatike të Kosovës

SKENDERAJ, 16 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka pritur të enjten në takim drejtorin e Akademisë Diplomatike të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, Beqir Ismailin, dhe diplomaten Valbona Fazliu-Rreci, me të cilët ka biseduar rreth zhvillimeve në këtë komunë si dhe kanë shqyrtuar mundësitë e bashkëpunimit në

të ardhmen. Po ashtu ata kanë diskutuar për organizimin e vizitave të ndërsjella në mes të kryetarit Jashari dhe niveleve të larta të disa prej shteteve arabe, siç janë Egjipti, Kuvajti etj. Kryetari Jashari e ka falënderuar Ismailin për kontributin e dhënë në pasqyrim të luftës së drejtë të popullit shqiptar, të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, por edhe për librat e botuar, për familjen

Jashari dhe luftën e lavdishme të UÇK-së. Në shenjë respekti, Jashari i ka dhuruar mysafirrit stemën e Komunës së Skenderajt. Beqir Ismaili, përveç angazhimit në jetën diplomatike të Kosovës, ka shkruar edhe shumë libra për familjen Jashari, Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, si dhe ka raportuar për medie ndërkombëtare për luftën e fundit në Kosovë.



## Macroni: Stabiliteti i Turqisë, i rëndësishëm për Francën

PARIS, 16 GUSHT - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka zhvilluar një bisedë telefonike me homologun turk Rexhep Tajip Erdogan dhe ka bërë me

dije se stabiliteti ekonomik i Turqisë është i rëndësishëm për Francën. Të dy presidentët theksuan rëndësinë e zgjerimit të lidhjeve ekonomike dhe tregtare

si dhe rritjen reciproke të investimeve, njofton "Associated Press".

Erdogani dhe Macroni kanë rënë dakord të takohen ministrat e

financave të të dy vendeve shumë shpejt. Kjo bisedë erdhi pasi Ankaraja nisi të tregonte shenja përmirësimi të marrëdhënieve me vendet evropiane.



# ShBA, presion Turqisë për lirim e pastorit Brunson

Pasi një gjykatë turke kundërshtoi të hënën një apel të dytë ligjor për lirim e tij nga arrestimi shtëpiak, ShBA-ja vazhdon trysninë ndaj presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan për ta liruar pastorin amerikan Andrew Brunson



WASHINGTON, 16 GUSHT - ShBA-ja vazhdon trysninë ndaj presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan për ta liruar pastorin amerikan, Andrew Brunson, pasi një gjykatë turke kundërshtoi të hënën një apel të dytë ligjor për lirim e tij nga arrestimi shtëpiak. Dhe Turqia po i kundërpërgjigjet presionit, duke rritur ndjeshëm tarifatat për një numër mallrash amerikane në hakmarje ndaj tarifave të vendosura javën e kaluar nga presidenti Trump për çelikut dhe aluminin turk.

Fati i pastorit amerikan Andrew Brunson kërcënon të shkaktojë

dëme të përhershme në marrëdhëniet ShBA - Turqi. "Ne mendojmë se Turqia, veçanërisht presidenti Erdogan, e kanë trajtuar pastorin Brunson, i cili e dimë se është njeri shumë i mirë dhe i krishterë i fortë që nuk ka bërë asgjë të keqe, shumë padrejtësisht, shumë keq. Dhe kjo është diçka që administrata amerikane nuk do ta harrojë", tha zëdhënësjja e Shtëpisë së Bardhë Sarah Huckabee Sanders.

Një gjykatë turke hodhi poshtë kërkesën e dytë të pastorit Brunson për lirim nga arresti shtëpiak, pasi qëndroi në burg

për 21 muaj nën akuza për spiunazh dhe terrorizëm. Shtetet e Bashkuara thonë se akuzat janë të rreme. "Ne jemi të zhgënjyer me atë njoftim. Do të donim që pastori Brunson të sillet në Shtetet e Bashkuara", tha zëdhënësjja e Departamentit të Shtetit, Heather Nauert.

Analistët thonë se refuzimi i presidentit turk Erdogan për lir-

imin e pastorit Brunson dhe amerikanët e tjerë të ndaluar në Turqi po krijojnë një krizë në rritje, pasi presidenti Donald Trump i filloi në kushtet e mira marrëdhëniet me presidentin Erdogan. "Hartuesit e politikave në ShBA nuk dinë çfarë të bëjnë me Turqinë, si të përpiqen ta detyrojnë, t'i bëjnë presion, ta nxisin, ta bindin Turqinë ta ndryshojë

sjelljen e saj. Dhe çështja e Andrew Brunson ka qenë diçka rreth së cilës gjithçka është kristalizuar", thotë Lisel Hintz pranë Shkollës John Hopkins për studime të avancuara ndërkombëtare. "Dhe tani vjen çështja e pastorit Brunson, në të cilën administrata besonte se kishte një marrëveshje dhe unë mendoj se Pompeo dhe Pence, të dy të krishterë të devotshëm, e shohin çështjen Brunson, gjithashtu në aspektin e kërçenimit të mundshëm të një komuniteti shumë të rëndësishëm ungjillor", thotë Aroon David Miller, analist pranë Qendrës Wilson.

Zyrtarë amerikanë thonë se janë duke vëzhguar pasojat ekonomike globale nga rënia e lirës turke, por shtojnë se kriza ekonomike e Turqisë është pasojë e politikës së Ankarasë.

## ShBA-ja dhe Kina pritet të zhvillojnë negociatat për tregtinë



PEKIN, 16 GUSHT - Një delegacion kinez pritet të udhëtojë drejt Shteteve të Bashkuara, më vonë gjatë këtij muaji, për t'i rifilluar negociatat, ndërsa është shtuar lufta tregtare mes dy ekonomive më të mëdha në botë.

Ministria kineze e Tregtisë njoftoi se zëvendësministri Wang Shouwen do të takohet me David Malpass, ndihmëssekretarin amerikan të Thesarit për Çështjet Ndërkombëtare.

Ministria publikoi një deklaratë ku thuhej se Pekini e mirëpret

dialogun, por "nuk do të pranojë asnjë masë kufizuese të njëanshme tregtare".

Që prej 6 korrikut, Kina dhe Shtetet e Bashkuara i kanë vendosur njëra-tjetres tarifa reciproke. Uashingtoni ka vendosur tarifa prej 25 përqindësh ndaj më shumë se 800 produkteve kineze me vlerë 34 miliardë dollarë. Pekini u hakmor me tarifa në të njëjtën vlerë ndaj 545 prodhimeve amerikane. Të dyja palët pritet të vendosin një raund tarifash shtesë me vlerë 16 miliardë dollarë, duke filluar më 23 gusht.

## Bullgaria do t'i rinovojë të gjitha urat pas fatkeqësisë në Itali

SOFJE, 16 GUSHT - Bullgaria ka vendosur të rinovojë më shumë se 200 ura pas shembjes së një ure në qytetin italian, Gjenova, është bërë me dije në një njoftim qeveritar të enjten, transmeton AFP.

Një total prej 211 urave, shumica e të cilave janë ndërtuar 34 apo 40 vjet më parë janë në gjendje të keqe, ka thënë ministria për Zhvillim Rajonal në një takim qeveritar.

Kryeministri bullgar Boyko Borisov ka thënë se të gjitha urat duhet të rinovohen dhe të forcohen. "Qoftë përmes kredive, të cilat më pas duhet t'i paguajmë me taksa, apo përmes buxhetit, dua që të gjitha urat të rinovohen në kohën e njëjtë", ka thënë ai në një takim një ditë më parë.

Bullgaria, shteti më i varfër në Bashkimin Evropian, ka pranuar për dekada ndihmë finan-

ciare nga Evropa për ta modernizuar infrastrukturën. Ky shtet është pothuajse katër herë më i madh se Belgjika, mirëpo ka 777 kilometra autostradë, pjesa më e madhe e cilave janë në gjendje të keqe. Një urë e autostradës që është shembur të martën në Itali, në kohën që po binte një shi i rrëmbyeshëm, ka lënë të vdekur të paktën 38 persona dhe ka plagosur 16 të tjerë.



Reportazh kulturor

# NË VLORËN HISTORIKE

**Bedri TAHIRI**

Takimet vëllazërore përherë e kanë atë bukurinë e vet mahnitëse, veçan kur ato bëhen midis krijuesish. Dhe, në raste të tilla, ngjajnë edhe mrekulli. Vushtriasit dhe vlonjatët sikur i lidh diçka e veçantë. Kështu ngjau edhe gjatë vizitës dyditore të delegacionit tonë (krijues të klubit "Latif Berisha": Ermirë Jusufi, Safet Hasani, Remzije Zekolli e Bedri Tahiri dhe zyrtarë komunalë: Besim Muzaqi, Fatmire Cecelia e Burim Rexhepi), që në vete ngërthenin gjithë afshin e frymës atdhetare, me një synim të për-bashkët: Ribashkimin kombëtar! Ishim të ftuar nga miqtë tanë vlonjatë, të prirë nga z. Thanas Jani (alias Nasi Jani) në përurimin e antologjisë së krijuesve të Klubit "Drita", që do të bëhej në Vlorë, më 6 gusht 2018. Kjo erdhi pas nënshkrimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi midis Klubit të

bashkëluftëtarët që nuk i ndau armiku as lufta, po i mban të ndarë djallëzia e injoranca e kohës. Vari bosh në Galicë po e pret tash e katërbëdhjetë vjet! Një kenataf bashkëkohor, për të cilin grekët e lashtë do të jepnin shumë!... Edhe dreka në Durrës, në restorantin "BESA" të Naim Kapitit, që mjaft domethënëse për ne. Vëllezërit Kapiti kanë dhënë shumë për luftën tonë çlirimtare, në lokalin e tyre "DRENICA" u bë mobilizimi i vullnetarëve që ktheheshin nga perëndimi dhe ia mësynin vatrave të luftës në Kosovë...

Rruga e gjatë nuk na lodhte fare. Fushën e Myzeqesë e kaluam duke rikujtuar romanet kryevepra të Jakov Xoxës. Hyrja e Fierit na sollti ndërmend Hanin e Bishtankës, ku Adili e Vita ngjizen farën e bukur të dashurisë...

Pritja e mysafirëve bëhet sipas traditës. Nikoqirët kanë dalë larg e larg, në hyrje të Vlorës heroike, dhe, sa takohemi, fill ngjitemi lart

**Në bordin e anijes pranë "Bolonjës" - Vlorë**

Dielli përvëlues sikur përtonte të fundosej tej horizontit të detit të paanë. Mbase edhe ai kishte dëshirë të merrte pjesë në eventin e thjeshtë kulturor, pa protokoll zyrtar, por të një rëndësie të veçantë, ku mplekësshin si gërshetë nimfash dy cepat e atdheut. Aty, në bordin e anijes së ankoruar, që herë-herë hepohej mbi ujin kaltërosh, do të flitej me gjuhën e perëndive, përmes fjalës poetike, nga anëtarët e dy klubeve: "Drita" dhe "Latif Berisha". Vlora e Vushtrria. Sa bukur! Mrekullia vetë!

Dhe, sipas rendit, që Labëria e çmon shumë, mysafirët në krye të vendit. Antologjia 5, me 140 shkrimtarë dhe artistë nga mbarë trojet shqiptare, fliste vetë. I madhi, Nase Jani, i zoti i shtëpisë në këmbë. Atmosferë mahnitëse. Nën zërin e bukur të gazetares Anila, çdo gjë frymon lehtë e qetë... Recitime, përshëndetje, kujtime, dhurime librash... Njohje e miqësi të reja...

Nën dritën vezulluese të hënës shihnim se si na bënin roje nderi ishulli më i madh i Shqipërisë, Sazani, e tej lart, puçur me qiellin, Kanina heroike, vendlindja e bejlerëve vlonjatë. Tryezat mbushur përplot: Mirënjohje, libra, kafe e pije freskuese... Fare pranë edhe piktura e piktores-poete, Mimoza Hametaj, dhuratë për "Drita" - "Pelegrin", në të cilën firmosëm të gjithë anëtarët e Klubit "Drita".

**Darkë tradicionale**

Vonë, pasi bëmë edhe ca shëtitje përgjatë bregdetit me hijeshi për-rallore, ngjitemi lart, në konakun mikpritës të Lela Qejvanit. Dhe, ç'të shihnim?! Një darkë tradicionale, me gjithë të mirat, të gjitha "bio", siç shprehet Nase Jani. Në përgatitjen e dy kecape në hell kishte ndihmuar edhe zonja e Nases, znj. Leonora, e cila, bashkë me të tjerat edhe na e shtroi sofrën



e bujarisë...

**Në Manastirin e Shën Mërisë**

Në të kthyer, nuk na bënte zemra t'i themi lamtumirë Vlorës pa kaluar pyllin e Sodës e për ta vizituar një mrekulli shqiptare, lagunën e Nartës, gjegjësisht ishullin e Vërnecit, ku në një qetësi hyjnore, nën gumëzhitjen dehëse të gjinkallave, sikur flinte Manastiri i Shën Mërisë, në varrezat e të cilit pushon edhe Marigona e Flamurit tonë të shenjtë...

**Dolli për Dritëronë!**

Në kuadër të kësaj mrekullie, ngjau edhe një drithërimë emocionuese, kur

poemën e Perikli Jorgonit, kushtuar Azem e Shotë Galicës, që vitin e shkuar e pata botuar në Prishtinë dhe Klubi ynë "Latif Berisha" e pati përuruar në kullën e Azem Galicës, ia dhurova z. Nase Jani, pa e ditur se ky paskësh qenë nxënësi i Perikliut të papërsëritshëm! Aty më doli edhe nxënësi tjetër i Periliut, ushtaraku e poeti Ylli Qemal Meçaj! Dhe, paskëtaj, u zbrazën emocione e kujtime të shumta.

Në përmblyllje edhe shkëmbime librash e kafeja lamtumirës. Nase Jani më dhuroi librin "...me Dritëronë", për të cilin edhe ngremë dolli, mu pranë shtatores së trimit Avni Rrustemi.

Faleminderit e gjithmonë qofshi të nderuar miq vlonjatë!

**Vlorë, më 6 e 7 gusht 2018**



Shkrimtarëve dhe Artistëve "Drita", Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport të Vushtrisë dhe Klubit Letrar "Latif Berisha", në kalanë e lashtë të Vushtrisë më 26 korrik 2018.

**Në Fushë-Krujën e Shotë Galicës**

Rrezet e diellit po përcëllonin ash-për, bashkë me pluhurin e rrugës së pashtruar tekta po zbrisnim ta nderonim heroinën e kombit, trimëreshën sypatrembur, Shotë Galica, e cila para 91 vjetësh na e kishte lënë shëndën, duke ikur në amshim në një gjendje të mjeruar! Ah, ç'katandisje kombëtare! Dymbëdhjetë vjet luftëra kundër katër perandorive pushtuese të kohës, gjashtëdhjetë e dy beteja fitimtare bashkë me kryetrimin Azem Galica e, në fund, tek po i rriste jetimët e shokëve të vranë, ende pa i mbushur mirë tridhjetë e dy pranvera, t'i mbyllë sytë në mjerim e pa bukë, një rast unik i llojit të vet! Dhe, marrëzitë, nuk kanë të ndalur. Bashkëshortët dhe

për kafën e mirë se ardhjes, nga, si në pëllëmbë të dorës shihet Vlora e Pavarësisë, Vlora e Ismail Qemalit, Vlora e Isa Boletinit, Vlora e mësuesit të Libohovës, Avni Rrustemit, Vlora e kujtesës sonë historike, emrin e së cilës e mbajnë shumë vasha në Kosovë. Këtë e mban edhe vajza ime e dytë, për të cilën më qortuan më vërejtje kur e regjistrova në vitin e demonstratave studentore, pra më 1981...




## Madonna feston 60-vjetorin e lindjes



**Y**lli i muzikës pop, aktore e regjisore, por edhe shkrimtare, ka mbushur 60 vjeç këtë të enjte. Emri i saj i plotë është Madonna Louise Veronica Ciccone, njihet shkurt me emrin Madonna dhe në karri-


erën e saj ka performuar në 10 turne koncertesh, sikurse ka shitur edhe mbi 300 milionë albume, duke u bërë kështu artistja femër me më shumë albume të shitura në të gjitha kohët, sipas librit të rekordeve botërore "Guinness".

## Paris Hiltoni shtyn datën e dasmës



**P**aris Hilton ka shtyrë dasmën me Chris Zylka. Muajin e kaluar u përhapen lajmet se çifti ishte duke planifikuar martesën, por duket se gjithçka është anuluar. "Parisi donte të martohej më 11 nëntor. Kjo ishte data e saj e preferuar, por ka

shumë gjëra për të bërë. Midis punës dhe orareve të saj të udhëtimit nuk ka kohë të mjaftueshme për ta organizuar dasmën", ka thënë një burim për "E! News". Sipas këtij burim, tani Paris Hiltoni ka planifikuar të martohet në pranverë.



## Një baba fatlum si Sylvester Stallone

**A**i është baba i tri vajzave bukuroshe, Sophia, 21 vjeçe, Sistine, 20 dhe Scarlet, 16. Sylvester Stallone nuk lë rast pa treguar krenarinë për këtë bekim në jetën e tij. Gjatë një darke në "Beverly

Hills", Sylvester Stallone ka pozuar me tri vajzat. Ylli i Hollivudit kishte veshur një këmishë të bardhë dhe pantallona të zeza. Pavarësisht prej viteve, Stallone duket në formë të përkryer.

## Angelina Jolie nuk e lejon Brad Pittin t'i shohë fëmijët



**S**ipas burimeve të afërta me aktoren e famshme, Angelina Jolie është duke i shkaktuar probleme ish-burrit Brad Pittit që t'i shohë gjashtë fëmijët e tyre. Gjyqtari i divorcit lëshoi një raport që kritikoi aktoren për moslejimin e fëmi-

jëve që të bashkëveprojnë me babanë e tyre, raporton "TMZ". Ndërsa më pas Gjykata ka vendosur t'i jepet një telefon Pittit me anë të të cilit mund të flasë me fëmijët dhe Angelina nuk mund t'i monitorojë bisedat.

# Zëvendësministrja Bakija-Deva priti në takim organizatorët e ekspozitës 'Kosovo NEXT10'

Prishtinë, 16 gusht (ER) - Zëvendësministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Burbuqe Bakija-Deva, ka pritur në takim përfaqësuesit e Shoqatës së Shkëmbimeve Kulturore të Kosovës dhe Tajvanit që organizuan ekspozitën "Kosovo NEXT10" me kuratoren Chiayo Kuo.

"Kosovo NEXT10" është një ekspozitë që bën vizualizimin e Kosovës në dhjetë vjetët e ardhshëm. Zëvendësministrja Bakija-Deva ka theksuar se nëpërmjet veprave të artit interaktiv ekspozita udhëzon vizitorët t'i eksplorojnë aspektet e ndryshme të Kosovës dhe të kontribuojnë me idetë e tyre për të ardhmen e Kosovës për krijimin kolektiv për ta ndarë atë me të tjerët. "Duke e parë nga afër ekspozitën dhe vazhdimin e saj, ky projekt jo vetëm se krijoi një moment his-

torik në ndërveprimin midis qytetarëve kosovarë dhe atyre tajvanezë, por do të krijojë mundësi për njerëzit që t'i mbledhin dhe ndajnë idetë e tyre për të ardhmen e Kosovës së bashku. Ne si institucion besojmë se duke mbështetur idetë dhe vlerat e shkëmbimit midis dy shoqërive mund të na ndihmojë t'i përmbushim sfidat dhe ta hapim komunikimin midis Azisë dhe Evropës Juglindore jo vetëm në aktivitete kulturore, por edhe në aspektin ekonomik, politik dhe më gjerë", ka thënë zëvendësministrja Bakija-Deva.

Në fund të këtij takimi Bakija-Deva ka dhënë edhe një intervistë për televizionin "News-Taiwan", në të cilën ka folur më gjerësisht në lidhje me ekspozitën në fjalë dhe përkrahjen e MKRS-së në projekte të tilla.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



Autor: GAZMEND MORINA	SUPER MODELJA & AKTORJA KOLUMBIANE NË FOTO 1 VERGARA	PËRPARIMI, GRADIMI	GRUP NJERËZISH TË BASHKUAR PËR TË BËRË VJEDHJE (sh.shq.)	OHAJO, LUIZIANA	QË NUK PLOTPJESË- TOHET ME DY (Mat.)	ZANORE	SYLEJMAN (perkdh.)	<b>EPOKA ERE</b>	FLOTA DETARE	QILIM QË SHTROHET NË NJË ANË TË OXHAKUT A TË DHOMËS	TONELATË	AKTORJA ITALIANE ROSELLINI (shqip.)							
PENGIM I NJË VEPRIMTARIE PËR QËLLIME ARMIQËSORE								KRAHINË NË SHQIPËRI (shq.) THEMELI											
QË KA TRAJTËN E VEZËS; VEZAKE						DRU QË PËRDORET PËR VEGLA MUZIKORE ADEM JASHARI													
... NOLI				LLOJ ZOGU KËNGËTAR QESENDISËS															
SHTET I MADH NË AZI (pashq.)					JEMENI GAZ LUFTE QË HELMON ORGANIZMIN		ZIMBABWE INSTITUTION ENGINEERS MËNYRË E VEÇANTË E TË VESHURIT				BASHKËTING, DYLUFTIMI								
TË FTOHTË I MADH; FRAQ (shq.)						SHTET NË EVROPË ... MARINO INDONEZIA, ZAIRI				"DETROIT" DIPLOMATI NORVEGJEZ ... EIDE									
<b>EPOKA ERE</b>	I TRASH A I PRISH TEHUN; I ÇMPREH SHALQI (shq.)							UJË I NGRIRË ISH FUTBOLLISTI CIMILI											
ISMET MUNISHI			EMËR YNI MASHKULLI LUMË NË SHQIPËRI (shq.)						"E" në mes të dy "A" AFTËSI E PAGIMIT (treg.)										
EMËR I VJETËR PËR EGJIPTIN						I LËKUN- DSHËM NË QËNDRIME IDHULL; IDOL						MË VJEN GJUMË E MË VARET KOKA DUKE NDENJUR							
ZANORE		SKUADËR KËNGËTAR I NJOHUR AMERIKAN					"MOLDE" TRAJNERI GUARDIOLA (BARCELONA)			ILAZ KODRA ZANORE		LËRE (bised.)	RRUGËTIM; PËRSHKRIMI I NJË UDHËTIMI	KËNGËTARJA & AKTORJA FRANCEZ PARADIS	ERION (shk.)	DUKURI E RE			
ZULMË				DAULLJA PËRFUNDIM NË SHAH							REGJISORI AMERIKAN ..... STONE QYTET NË KOSOVË								
I ZË ME DORË					ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ SHERINGEM "KENSAS"					BURRË SHTETI (shq.) SHTET FEDERAL NË SHBA									
BUJTINË, HAN						BIMË QË PËRDORET GJERËSISHT SI UDHQIM NDËRRIM I MALLIT						FUTBOLLISTI FETAHU SHKRONJAT E PARA							
BASHKIM I FORTË DHE I PANDASHËM						SHKRIMTARJA KAMBERI BISKOTË E GATUAR ME ARRA (shq.)									ZANORE TRIBUNI DEMAÇI (shq.)				
<b>2</b>								FUTBOLLISTI ... CAHILL (EVERTON) IRNOSET (bised.)			FJALA E DHËNË PËR DIÇKA TË RË- NDËSISHME "TENESI"								GRIMCOVA (bised.)
		PREZANTUESE E NJOHUR SHQIPTARE							NJË E PANJOHUR NË MATEMATIKË SPECIALIST PËR KIRURGI			KËNGËTARJA ROZANA .... NDODHI (krah.)							
		ISH FUTBOLLISTI HOLANDEZ VAN BASTEN									MODELJA SHQIPTARE ... PEPAJ ZANORE		EDVIN MURATI ZANORE						
		<b>EPOKA ERE</b>	PORTIERI SPANJOLL JOSE MANUEL SHEPËZË SHTËPIAKE (sh.shq.)									ERA E MIRË MODELJA SHQIPTARO- AMERIKANE ÇUNMULAJ							
	SUPER MODELJA ÇEKE NË FOTO 2 NEMCOVA								ERNEST KOLIQI PËRËNDESHË E DASHURISË (mit. romake)			DY BASHKË- TINGËLLORE	ISLANDA GAZ PA NGJYRË DHE PA ERË			BANOR I HERSHËM I NJË KRAHINE			
	UGANDA, TAJLANDA					ZANORE NJË (ang. shqip.)			EMËR FEMRE MYSLIMANE ARMATA IRLANDEZE (shk. orgj.)				ZANORE AMPER, RENIUM						
	DHËNIA E NJË ÇMIMI TË LARTË											KASOLLE E BARINJVE INDIRA GANDI							
	ARMENIA				MBRET ILIR (shq.) ZANORE								TOKA E PUNUAR ZANORE						
	NGJYRË E LËKURËS SË FYTYRËS							TRAJNERI SPANJOLL LUIS .....											

ZGJIDHJA E FJALËKRËYQIT: SABOTIM, MATI, OVALE, ABANOZ, FAN, KANARINA, INDI, J, ZIE, B, ACARI, SAN, DE, I, TOPTI, AKULL, IM, NEZIR, AEA, MISIR, LABIL, O, EKIP, MO, IK, NAM, TUPANI, OLIVER, I, KAP, TED, SHTETARI, KONAK, PATATE, ENIS, UNITET, NERIMANE, I, RA, TIM, BESSA, AMI, ZET, RAD, MARKO, EVA, EM, REINA, AROMA, PETRA, EK, I, UT, U, AMIRE, A, LAURIMI, STAN, A, AGRONI, ARA, TEN, ARAONES.



E jashtëzakonshme

## Skatebordi e shpëton 13-vjeçarin nga rrufeja

Duket e pabesueshme, por është e vërtetë. Një 13-vjeçar i ka mbijetuar për mrekulli goditjes vdekjeprurëse të një rrufeje, sepse në dorë mbante një skateboard. Josia Wiedman po luante me një shok kur mbi të u shkarkua rrufeja. Ai u mbrojti nga forca e plotë e valës elektrike sepse kornizat metalike të skateboardit e shkarkuan energjinë e lëshuar në tokë.



## BARSOLETA E DITËS



**Mësuesi, nxënësit:**  
- Ma thuaj emrin e një qyteti në Angli.  
- Për cilin qytet e keni fjalën?



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjate vikendit  
në ora 16:00

## “INCREDIBLES 2” 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird



FOTO E DITES



Makina dhe kamionë shihen në një rën pjesë të urës së shembur në Gjenovë. /AP/

Në ora 18:20

## “FUTURE WORLD”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco



Në ora 20:00

## “ANT-MAN AND THE WASP” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed



Në ora 22:00

## “LOVING PABLO” (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

**Regjia:** Fernando León de Aranoa



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

E rrallë

## Pronari i birrës 'Corona' investon katër miliardë dollarë në kanabis

Pronari i kompanisë së birrës "Corona", Constellation Brands, ka vendosur të investojë rreth katër miliardë dollarë për prodhuesin më të njohur të kanabisit në Kanada, Canopy Growth,



në një marrëveshje që shënon investimin më të madh në këtë industri deri më tani. Firma e alkoolit dëshiron të përfitojë nga legalizimi në rritje i drogës.



**DASHI**

Dita sot do të fillojë me një surprizë të këndshme. Edhe pse nuk është ajo që prisnit, përsëri do të kënaqeni me aq sa do t'ju jepet.



**DEMI**

Sot do të keni lëvizje shumë të forta emocionale. Kjo ditë që nisi shumë qetë mund të kthehet në një nga ditët më të paharruara për ju.



**BINJAKËT**

Këto kohë nuk keni mundur të frenoni situata të sikletshme të provokuara nga persona që nuk kanë marrëdhënie shumë të mirë me ju.



**GAFORRJA**

Keni marrë shumë informacion nga fusha të ndryshme dhe ndiheni mjaft i mbushur shpirtërisht. Këto ditë duhet t'i kaloni me pranë familjes.



**LUANI**

Sot përfitimet tuaja nga një projekt do të jenë mjaft të dukshme. Kjo gjë do të manifestohet me batuta xhelozie nga kolegët.



**VIRGJËRESHA**

Mbase keni frikë të merrni përgjegjësi të reja mbi vete, por nëse ju pëlqejnë sfidat, duhet ta provoni. Çdo gjë e ka një të mirë nga pas.



**PESHORJA**

Nëse e ndieni veten jo shumë të mirëkuptuar nga partneri sot, mbase duhet të uleni dhe të diskutoni për ngërçin që ka lidhja juaj.



**AKREPI**

Ka shumë persona që nuk kanë besim tek ju sepse nuk keni vënë asnjëherë në praktikë ato që keni thënë. Sot është dita e duhur për të ndryshuar mendim.



**SHIGJETARI**

Nëse e shihni çdo gjë me optimizëm dhe e ardhmja do t'ju duket shumë e mirë dhe me mjaft mundësi të reja për të shfrytëzuar.



**BRICJAPI**

Mund të jeni krenar për veten, sidomos për pjesëtarët e familjes tuaj. Sot do të tregoni që jeni më shumë se kurrë bashkë në qëllimet e mira.



**UJORI**

Sot do të merrni vendime edhe për persona të tjerë pranë jush që nuk kanë mundësi të vendosin për gjëra të mëdha në jetën e tyre.



**PESHQIT**

Bëni një bashkë-bisedim me veten sot për të kuptuar se cilat janë gjërat që kanë vërtet rëndësi në këto çaste në jetën tuaj.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BIRMINGHAM - SWANSEA

1

CADIZ - ALMERIA

1

AACHEN - WIEDENBRUCK

1

# Ahmeti: Futbollli i Kosovës është në rrugë të duhur

Ish-lojtari i Prishtinës, Azem Ahmeti, ka vlerësuar se futbollli i Kosovës është në rrugën e duhur, por mendon se institucionet përgjegjëse duhet të punojnë më shumë në rregullimin e infrastrukturës. "Futbollli ynë që nga pranimit në UEFA dhe FIFA është duke ecur në rrugën e duhur dhe me hapa të mëdhenj, por duhet me shumë investime në infrastrukturë", ka thënë Ahmeti

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 16 GUSHT** - Një nga lojtarët më të mirë në futbollin e pasluftës është Azem Ahmeti, i cili sukseset më të mëdha i arriti në skuadrën e Prishtinës, duke qenë kapiten dhe "motor" i lojës së këtij klubi për shumë vjet me radhë. Në fakt, Ahmeti luajti tetë vjet për skuadrën e Prishtinës, më pas u largua në mënyrë jo të mirë edhe përkundër faktit se kontributi i tij ishte i madh.

Azem Ahmeti të enjten për "Epokën e re" ka thënë se futbollli i Kosovës është në rrugën e duhur por, sipas tij, ndeshja finale e Superkupës e ka dëshmuar edhe një herë se investimi në infrastrukturë është i domosdoshëm. "Futbollli ynë që nga pranimit në UEFA dhe FIFA është duke ecur në rrugën e duhur dhe me hapa të mëdhenj, por duhet me shumë investime në infrastrukturë. Ndeshja finale e Superkupës dëshmoi se infrastruktura është elementi kryesor në ngritjen e cilësisë në futboll dhe pikërisht në këtë ndeshje patëm mundësinë të shohim lojë më të shpejtë sesa që shohim zakonisht nëpër terrenet



tona. Fusha u jep mundësi të dyja skuadrave ta qarkullojnë më mirë topin dhe t'i shfaqnin cilësitë e tyre, por edhe pamja e stadiumit dhe tifozët në numër të madh ndikojnë në ngritjen e cilësisë për faktin se loja e futbollit zhvillohet për ta", ka thënë Ahmeti.

Aktualisht mesfushori nuk është duke i zhvilluar përgatitjet me skuadrën e Flamurtarit. Ai nuk dha shumë detaje, por la të kuptohet se ka mosmarrëveshje me këtë klub dhe se deri në janar mund të mos luajë asnjë ndeshje. "Kam kontratë me klubin e

Flamurtarit deri në janar, pastaj të shohim se si do të vendos për të ardhmen time", ka shtuar Ahmeti. Futbollisti që ka bërë karrierë në Prishtinë, Flamurtar, Hajvali dhe Gjilan, ka thënë se në të ardhmen mund të merret me zejen e trajnerit. "Pasi ta mbylli karrierën si futbollist do të jetë një mundësi e mirë ta vazhdoj karrierën në lidhje me futbollin. Nuk kam vendosur ende diçka, por me gjasë do të merrem me zejen e trajnerit që mendoj se është mjaft tërheqëse dhe sfiduese", ka deklaruar Ahmeti.

# Flamurtari i Vlorës transferon Mustafën

**VLORE, 16 GUSHT** - Flamurtari rikonfirmoi pretendimet për titullin kampion në futbollin shqiptar, me një merkato cilësore dhe afrimin e trajnerit me përvojë, Ilir Daja. Por, formacioni bregdetar nuk është ndalur as këtë javë, duke vendosur nën kontratë një tjetër përforsim të rëndësishëm, si mesfushori Argjent Mustafa.

Klubi kuqezi zyrtarizoi afrimin e futbollistit, që pritet të sjellë muskuj dhe përvojë në repartin e mesfushës, për shkak të përvojës së madhe në elitën e futbollit shqiptar. Ai ka luajtur me shumë ekipe, si Partizani, Laçi, Tirana apo Kamza, ndërsa aventura e fundit e Mustafës ishte të Vushtrria në Kosovë. Mbetet për t'u parë nëse trajneri i Flamurtarit do të vendosë t'i besojë



një fanellë si titullar lojtarit nga Mitrovica, që nuk është stërvitur me ekipin. Vlonjatët debutojnë këtë

sezon në Kategorinë Superiore me ndeshjen në transfertë ndaj Teutës, të dielën në orën 19:45.

## SHKURT

### Kosova dhe Shqipëria nuk ndryshojnë, Franca e para në renditjen e FIFA-s

Franca merr kryesimin e renditjes botërore të FIFA-s, menjëherë pas triumfit në Kupën e Botës 2018 dhe përllogaritjes së klasifikimit me formulën e re, e cila ka hyrë në fuqi prej muajit qershor. "Gjelat" e shohin veten më lart se të gjithë, duke fituar gjashtë vende. Franca rikthehet në krye për herë të parë pas 16 vjetësh, ku për herë të fundit ishte në maj të vitit 2002. Gjithsesi, blutë i ndajnë vetëm tri pikë nga gjysmëfinalistët e Botërorit. Belgjika është ngjitur në vendin e dytë, duke ndryshuar vendin me Brazilin, ndërsa Kroacia u ngjiti në vendin e katërt. Arritja e finales bëri që ekipi ballkanas të fitonte plot 16 vende. Lëvizje të tjera të mëdha ishin ato të Uruguait, që u ngjiti në vendin e pestë, Anglia në të gjashtin, Suedia në të 13-tin dhe Rusia në të 49-in. Bazuar në rezultatet e Kupës së Botës, pati edhe skuadra që pësuan rënie të madhe. Gjermania humbi 14 vende dhe tashmë është e 15-ta. Për sa i takon Shqipërisë, kuqezinjtë mbeten në vendnumëro, në vendin e 58. Asnjë ndryshim edhe për përfaqësuesen e Kosovës, e cila mbetet në vendin e 141-të nga renditja me 206 skuadra.

### Fetahaj, Hodaj dhe Binishi te Liria

Më në fund ka përfunduar "telenovela" e gjatë rreth të ardhmes së Liridon Fetahajt. Futbollisti në fjalë është larguar nga Prishtina dhe është rikthyer sërish te skuadra e Lirisë. Skuadra prizrenase ka zyrtarizuar edhe dy afrimet e fundit për sezonin e ri futbollistik. Bëhet fjalë për portierin Dilon Hodaj dhe mesfushorin Gentian Binishi, që e çojnë në 16 numrin e lojtarëve të afruar vetëm gjatë kësaj periudhe verore. Hodaj rikthehet te skuadra prizrenase pas përvojës së fituar te Ferizaj, ndërsa djaloshi Binishi është prodhim i shkollës vendëse dhe konsiderohet një element me shumë cilësi.

### Kosova pëson humbje nga Bullgaria në Evropianin U18

Hendbollistët e Kosovës pësojnë ndaj Bullgarisë në Evropianin U18. Ndonëse kishte shpresë për fitoren e parë në ndeshjen ndaj Bullgarisë, kjo nuk ndodhi. Përfaqësuesja U-18 e Kosovës në hendboll ka humbur edhe ndeshjen e pestë dhe të fundit në fazën grupore të Evropianit të Divizionit B që po mbahet në Austri. FHK-ja përmes faqes zyrtare njofton se rezultati i ndeshjes të luajtur të enjten paradite ishte 29:23 në të mirë të Bullgarisë. Kështu Kosova përfundon fazën grupore në vendin e fundit (6) në Grupin B. Në ditët në vijim i ka edhe dy ndeshje për plasman përfundimtar. "Në ndeshjen ndaj Bullgarisë dallimi është bërë në pritjet e portierëve. Derisa portierët bullgarë kanë ndalur më shumë se gjysmën e gjuajtjeve në drejtim të portës së tyre, portierët tanë nuk e kishin ditën dhe kanë bërë fare pak pritje. Po ashtu, shumë gjuajtje joefikase kishte hendbollisti kryesor i kombëtares tonë Yli Muqolli, që u ndal në tri gola", thuhet në njoftim.

## Messi flet si kapiten: LK-në do ta rikthejmë në "Camp Nou"

BARCELONË, 16 GUSHT - Leo Messi u tregua ambicioz në fjalimin e tij të parë si kapiten i Barcelonës. Futbollisti argjentinas ka premtuar se do ta japë maksimumin për të rikthyer në "Camp Nou" trofeun e Ligës së Kampionëve, që në tre

edicionet e fundit është fituar nga Real Madridi. "Sa për këtë vit, ne kemi krijuar një skuadër të fortë. Blerjet na kanë bërë edhe më të mirë sesa vjet. Edhe pse vitin e kaluar u kënaqëm me kampionatin dhe Kupën e Mbretit, u mërzitëm për

Ligën e Kampionëve, për mënyrën se si u eliminuam. Premtojmë se do të bëjmë çdo gjë të mundshme në mënyrë që ajo kupë aq e bukur dhe e dëshiruar nga të gjithë të kthehet në fushë tonë", ka thënë Messi. Për sa i përket faktit që këtë sezon

do të jetë kapiteni i parë i Barcelonës, Messi ka deklaruar: "Për mua është një krenari e madhe. Unë e di se çfarë duhet të jetë kapiteni i këtij klubi. Kam qenë me fat sepse kam pasur shembuj të shkëlqyer si Puyol, Xavi dhe Iniesta".



## Guardiola: Dua ta zhduki dominimin e Unitedit

MANCHESTER, 16 GUSHT - Pep Guardiola po mundohet t'i japë fund dominimit të futbollit anglez nga Manchester United. Madje kjo është sfida e tij më e madhe si trajner i Manchester City. Ndërsa "Djajtë e Kuq" nuk e kanë fituar dot titullin e Premier Ligës që pas pensionimit të Sir Alex Ferguson në vitin 2013. Manchester City ka shpenzuar shumë në një përpjekje për ta kapërcyer boshllëkun mes rivalëve më të ashpër, me "fqinjët e zhurmsëm" që kërkonin ta merrnin kontrollin në Manchester dhe konkurrencën e brendshme në Angli. Guardiola i ndihmoi ata të krijojnë dominimin me rekord pikësh në sezonin e kaluar, me titullin kampion dhe dy "Carabao Cup". Ai pranon se është i vendosur të shtojë trofe të tjerë. Pep Guardiola ka thënë për "All or Nothing", një dokumentari të ri të "Amazon", i cili u përqendrua në aktivitetet e stadiumit "Etihad": "Ne kemi fqinj Manchester United, klub i cili për 15 apo 20 vjet ka fituar gjithmonë. Mendoj se sfida ime më e madhe si trajner është ta ndryshojë këtë". Guardiola u vendos në krye të Manchester City në sezonin 2016-2017, duke e përfunduar sezonin e tij debutues në Angli me duar bosh, pa asnjë trofe. Sezonin e kaluar ndihmoi në rritjen e reputacionit të katalanasit si një nga trajnerët më të mirë në



botë, raporton "Telesport". Ish-trajneri i Barcelonës dhe Bayern Munich, 47-vjeçar, vazhdon të korrë shumë fitore, por ai pretendon se ka të meta si njeri, që përpiqet t'i mbulojnë. "Do t'ju tregoj diçka, që është absolutisht e vërtetë: nuk i kam as unë të gjitha përgjigjet. Shpesh, kur nuk di diçka, veproj para lojtarëve sikur kam njohuri. Unë veproj kështu, që futbollistët të besojnë se i kam përgjigjet e duhura. Kjo u jep atyre besimin për të luajtur", ka shtuar ai. Kjo qasje i ka shërbyer për mirë Guardiols në këtë pikë, me një formulë fituese, që është gjetur nga një njeri, i cili e bëri tranzicionin nga lojtar në trajner të dukej jashtëzakonisht

i lehtë. Trajneri katalanas vazhdoi në fjalën e tij: "Më pëlqen të kem një dhomë zhveshjeje të zhurmsme para një ndeshjeje. Ndihej se kjo i animon lojtarët më shumë. Ajo që më mungon nga koha ime si ish-lojtar është dhoma e zhveshjes. Është vendi më i mirë për të qenë, përveç fushës së blertë. Aty ka shaka, të gjithë janë së bashku, lojtarët mund të kritikojnë edhe trajnerin e të ndajnë çastet e mira dhe të këqija". Manchester City, i cili mori një fitore të lehtë 2-0 ndaj Arsenalit, në fushën e këtij të fundit, kur ngriti siparin e sezonit të ri në Premier Ligë, të shtunën do ta presë Huddersfieldin në stadiumin "Etihad".

## Schumacheri do të vazhdojë rehabilitimin në Spanjë

MAJORKA, 16 GUSHT - Michael Schumacher do të lërë Zvicrën dhe do të transferohet në një vilë luksoze në Majorka të Spanjës, ku do ta vazhdojë rehabilitimin pas aksidentit me ski që ka pësuar gati pesë vjet më parë. Corinne, bashkëshortja e shtatë herë kampionit të botës, ka blerë së fundi një vilë (Villa Yasmin) me vlerën e 30 milionë eurove në zonën e Andratx, 20 minuta nga Palma de Majorka. Lajmin e transferimit e ka konfirmuar edhe kryetari i Bashkisë së Majorkës: "Mund të konfirmoj se Michael Schumacher do të qëndrojë në qytetin tonë dhe ne jemi gati për ta mirëpritur". Mediet zvicereane pohojnë se policia në Majorka është informuar për ardhjen e pilotit gjerman dhe ka gati një plan për ta ruajtur privatësinë e ikonës së garave të Formula 1, ende në periudhë rehabilitimi, për të cilin ende nuk ka



informacion për gjendjen shëndetësore. Ndërkohë që, familja e Schumacherit nuk e ka komentuar këtë transferim në Spanjë. Në këtë qytet, çifti ka kaluar shpesh pushimet, ndaj është

një zonë që ata e njohin mirë. Michael Schumacheri është aksidentuar më 29 dhjetor të 2013-s, teksa bënte ski dhe më 3 janar të vitit të ardhshëm do të festojë 50-vjetorin e lindjes.

### SHKURT

#### Tortoshi licencohet nga FFK-ja

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, i dorëzoi licencën e parë të ndërmjetësuesit në futboll, trajnerit të mirënjohur Jusuf Tortoshit. Tash e tutje klubet dhe futbollistët duhet t'i drejtohen Tortoshit. Sekretari i përgjithshëm i FFK-së, Eroll Salihu, ka bërë me dije se në këtë drejtim janë licencuar edhe individë dhe kompani të tjera për ndërmjetësim.

#### Griezmanni tregon pse nuk u largua nga Atletico

Një muaj pasi e ngriti trofeun e Kupës së Botës me Francën, Antoine Griezmann e ka marrë medaljen e argjendtë edhe të Superkupës së Evropës. Ai ka bërë me dije se nuk u largua nga klubi madrilen sepse besonte te trajneri Diego Simeone dhe projektin e klubit. "Kam qëndruar sepse kemi një projekt të madh. Kam besim në këtë klub dhe në Diego Simeonen", ka thënë Griezmann.

#### Kroosi kritikon Ozilin

Toni Kroos thotë se një pjesë e madhe e deklaratës së Mesut Ozilit për largimin nga ekipi kombëtar është 'marrëzi'. Ozili njoftoi pensionim nga ekipi kombëtar, duke thënë se ishte viktimë e racizmit dhe se performanca e tij me Gjermaninë është vënë në pikëpyetje për shkak të prejardhjes së tij turke. "Në thelb, Mesut është një lojtar i merituar kombëtar dhe si futbollist ai do të kishte merituar një dalje më të mirë. Kam luajtur me Mesut për shumë vite dhe e di se ai është një djalë i mirë", ka thënë Kroos për "Bild".

#### Ospina huazohet te Napoli

Skuadra e Napolit e ka gjetur portierin e ri, i cili është David Ospina. Trajneri Carlo Ancelotti mund të llogarisë në portierin 29-vjeçar, i cili ka një karrierë të pasur me Arsenalin dhe Kolumbinë. Sezonin e fundit Ospina është aktivizuar në 21 ndeshje në total: 5 në Premier Ligë, 10 në Evropa Ligë, 5 në Kupën e Ligës dhe 1 në FA Cup.

#### Simeone në histori të Atletico

Pas triumfit në Superkupën e Spanjës, Diego Simeone është shndërruar në trajnerin më të suksesshëm për skuadrën e Atletico Madridit. "Cholo" siguroi trofeun e 7 të rëndësishëm në drejtimin e "Los Colchoneros", duke lënë pas një legjendë si Luis Aragones, që në katër vjet si trajner i Atletico kishte fituar gjashtë trofe të ndryshëm. Para se të ngrinte lart Superkupën e Evropës, në stadiumin e Talinit, Simeone triumfoi në dy finale të Evropa Ligës, mori më parë të njëjtën Superkupë, si dhe triumfoi në Kupën e Mbretit dhe Superkupën e Spanjës. Trajneri argjentinas bëhet trajneri i parë në historinë e Atletico që kalon rivalët e një qyteti në tre finale të ndryshme. Simeone ka mundur Realin në Superkupën Evropiane, Superkupën e Spanjës dhe Kupën e Mbretit.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government  
Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-141 për Provimin e Jurisprudencës dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 13/2013 për mënyrën e dhënies dhe programin e provimit të jurisprudencës, Ministria e Drejtësisë publikon:

### **SHPLLJEN PUBLIKE PËR DHËNIEN E PROVIMIT TË JURISPRUDENCËS**

Ftohen të gjithë kandidatët e interesuar të cilët dëshirojnë që të aplikojnë për dhënie të Provimit të Jurisprudencës në afatin e Shtatorit 2018 se:

Afati për dorëzimin e aplikacioneve për dhënie provimit të jurisprudencës fillon prej datës **17 Gusht 2018** deri me **29 Gusht 2018**.

**Provimi me shkrim do të mbahet me datën 22 dhe 23 Shtator 2018.**

Kërkesës për dhënie të provimit të jurisprudencës e cila merret në Faqen Zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, duhet t'i bashkëngjisi dokumentet e **vërtetuara** me të cilat dëshmohet se i plotëson kushtet ligjore, si në vijim:

Diplomën e Fakultetit Juridik, sipas programit katër vjeçar ose studimet master, kopja e Diplomës duhet të jete e NOTERIZUAR;

Vërtetimin për përvojën e punës juridike pas diplomimit konform nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-141 për Provimin e Jurisprudencës, Vërtetimi duhet të dorëzohet kopje e NOTERIZUAR;

Certifikatën e shtetësisë së Republikës së Kosovës;

Kopjen e letërnjoftimit;

Nëse kandidati fakultetin e ka të përfunduar në shtetin tjetër, atëherë kandidati duhet ta sjell diplomën e nostrifikuar dhe Vendimin nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës. Diploma dhe Vendimi duhet të dorëzohen në kopje të NOTERIZUARA.

Dokumentacioni i pakompletuar sipas kërkesave të përcaktuara në konkurs, është bazë që Komisioni të refuzoj Kërkesën për lejimin e dhënies së Provimit të Jurisprudencës.

Kandidatët të cilët kanë mbetur në riprovim nga afati i Qershorit 2018 duhet ta paraqesin kërkesën brenda këtij afati për të ju nënshtruar Riprovimit në afatin e Shtatorit 2018.

Kandidatëve të cilëve me parë ju është aprovuar kërkesa për dhënie të provimit të Jurisprudencës, e të cilët dëshirojnë t'i nënshtrohen Provimit në këtë afat, duhet të paraqesin kërkesë për dhënie të provimit të jurisprudencës e që merret në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, e cila duhet të përmbajë të dhënat personale dhe vitin në të cilin ju është lejuar dhënie të provimit të Jurisprudencës.

Kërkesa për dhënie të provimit të jurisprudencës dorëzohet në Ministrinë e Drejtësisë, Ish-Ndërtesa e Rilindjes kati përdhese Arkivi i Ministrisë së Drejtësisë, Prishtinë, Republika e Kosovës, çdo ditë pune, nga ora 08:00 deri 16:00.

Kandidatit me vendim i lejohet hyrja në provimin e jurisprudencës, për datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së provimit me shkrim dhe me gojë kandidatët do të njoftohen përmes njoftimit të publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

Për informata të hollësishme mund të drejtoheni në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë <http://www.md-ks.org>, ose në nr: 038 20018264 dhe 18111.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government  
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Na osnovu Zakona br . 04/L-141 za Pravosudni Ispit i člana 4 Administrativnog Uputstva br. 13 / 2013 o načinu i programu polaganja Pravosudnog Ispita, Ministarstvo Pravde objavljuje ovu:

### **JAVNO OBAVEŠTENJE ZA POLAGANJE PRAVOSUDNOG ISPITA - PISMENI DEO**

Pozivaju se svi zainteresovani kandidati koji žele da se prijave za polaganje pravosudnog ispita u septembru 2018 , da:

Rok za predaju aplikacije za polaganje pravosudnog ispita počinje od **17 avgusta 2018** do **29 avgusta 2018**.

**Pismeni ispit će se održati dana 22 i 23 septembra 2018.**

Zahtevu za polaganje pravosudnog ispita koji se dobija na zvaničnom sajtu Ministarstva pravde, moraju biti priložiti **overene** dokumente, dokazujući da su ispunjeni zakonski uslovi, kao što sledi;

- Dokaz o završetku Pravnog fakulteta, prema četverogodišnjem programu ili master studije, i kopija diplome mora biti NOTERIZOVANA;

- Dokaz o radnom iskustvu u pravnoj oblasti nakon diplomiranja u skladu sa Zakonom Br. 04/L-141 o pravosudnom ispitu, Potvrda se mora dostaviti kao NOTERIZOVANA kopija;

- Uverenje o državljanstvo Republike Kosovo;

- Kopija lične karte;

- Ako je kandidat završio fakultet u drugoj državi, onda treba da donese overenu (nostrifikovanu) diplomu i odluku od strane Ministarstva obrazovanja, nauke i tehnologije Republike Kosova. Diploma i Odluka moraju biti dostavljene u OVERENIM (NOSTRIFIKOVANIM) kopijama.

- Nekompletirana dokumentacija prema zahtevima utvrdjenim u konkursu, je osnova da Komisja odbije zahtev za polaganje pravosudnog ispita.

- Kandidati, koji ponavljaju ispit ( od roka u Juni 2018) moraju podneti pismeni zahtev, unutar ovog zakonskog roka za ponovno preispitivanje u septembru 2018 godine.

- Kandidati koji su ranije dobili odobrenje za polaganje ispita i koji žele da polažu Ispit u ovom roku moraju podneti zahtev za polaganje pravosudnog ispita koji se dobiva na službenoj veb stranici Ministarstva pravde, i taj zahtev sadrži lične podatke i godinu u kojoj ste dobili odobrenje za polaganje pravosudnog ispita.

Zahtev za polaganje pravosudnog ispita se podnosi u Ministarstvo Pravde, Bivša-Zgrada Rilindje, 8 (osmi) sprat, kancelarija br. 803, Priština, Republika Kosovo, svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova.

Sa odlukom, kandidatima se dozvoljava učešće u pravosudnom ispitu.

Za datum , vreme i mesto održavanja pismenog i usmenog ispita, kandidati će biti obavješteni putem zvaničnog web sajta Ministarstva pravde .

**Za detaljnije informacije možete se obratiti na Web sajtu Ministarstva Pravde <http://www.md-ks.org> ili kontakt tel: 038 200 18074 i 18111.**

Republika e Kosovës  
Komuna e Malishevës

Drejtoria Për Arsim dhe Edukim

Nr: 11/

Më: 16.08.2018

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.10/2018 datë: 20.07.2018. Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:

**KONKURS**

Për plotësimin e vendeve të punës

Viti shkollor 2018/2019

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Numri i pozitave	orë
19	SHFMU" Bajram Curri" në Drenoc	Edukatore	Zëvendësim i lehonisë me kohe të caktuar	1	20

**I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Formulari i aplikimit
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmitë e përvojës në institucionet arsimore ( nëse ka)
- Certifikata e lindjes

**II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar.

❖ **Kriteret e kualifikimit:** Për vendin e punës edukatore kërkohet kualifikimet: **Fakulteti i edukimit -programi parashkollor; shkolla e lartë pedagogjike-drejtimi për edukatore; Fakulteti Filozofik -dega e pedagogjisë së përgjithshme, Fakulteti i shkencave sociale-programi përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve** ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm Nr. 10/2018 datë 20.07.2018.

Vetëm në mungesë të kandidatëve të kualifikuar nga sqarimi i lartcekur, do të shqyrtohen edhe aplikacionet tjera .

**III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.**

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente ( jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

SQARIM: Kandidatët mund të konkurrojnë në më shumë shkolla, por me dokumente të veçanta.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kanë diplomat e nostrifikuara në MASHT.

**Për intervistë do të ftohën ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.**

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në web- faqen e Komunës së Malishevës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

**Afati dhe mënyra e aplikimit**

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **16.08.2018 më datën:30.08.2018**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes zyrës së pritjes së palëve, në objektin e ri të Komunës së Malishevës.

Republika e Kosovës  
Komuna e Malishevës

Drejtoria Për Arsim dhe Edukim

Nr: 11/582

Më: 16.08.2018

Bazuar në Vendimin e Inspektoratit të Punës dt. 02.08.2018 nr. 11/711/2018 e në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 10/2018 datë: 20.07.2018. Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. dhe vendimit të Drejtorisë për Arsim dhe Edukim për anulimin e konkursit për 10 orë mësimi datë: 16.08.2018 Nr. 11/581. Drejtoria për Arsim dhe Edukim **rishpall:**

**KONKURS**

Për plotësimin e vendit të punës

Viti shkollor 2018/2019

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Numri i pozitave	orë
1	SHFMU" Ibrahim Mazreku" në Malishevë	Mesimdhënës i lëndës së teknologjisë-informative	Vend i lirë	1	10

**I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Formulari i aplikimit
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmitë e përvojës në institucionet arsimore ( nëse ka)
- Certifikata e lindjes

**II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar.

❖ **Kriteret e kualifikimit:** Për vendin e punës Teknologji Informative kërkohet kualifikimet: Programi /dega teknologji-informatikë; niveli master arsimor-Fakulteti i Edukimit( 300 ECTS); sistemi katërvjeçar; Baçelor ( katërvjeçar 240 ECTS); Programi: matematikë-informatikë; niveli master arsimor-Fakulteti i Edukimit( 300 ECTS); sistemi katërvjeçar; Baçelor ( katërvjeçar 240 ECTS) ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm Nr. 10/2018d date: 20.07.2018.

Vetëm në mungesë të kandidatëve të kualifikuar nga sqarimi i lartcekur, do të shqyrtohen edhe aplikacionet tjera .

**III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.**

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente ( jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

SQARIM: Kandidatët mund të konkurrojnë në më shumë shkolla, por me dokumente të veçanta.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kanë diplomat e nostrifikuara në MASHT.

**Për intervistë do të ftohën ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.**

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në web- faqen e Komunës së Malishevës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

**Afati dhe mënyra e aplikimit**

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **16.08.2018 më datën:30.08.2018**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes zyrës së pritjes së palëve, në objektin e ri të Komunës së Malishevës.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Komuna Junik  
Dt.17.08.2018

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, neni 17, në bazë të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës nenet 7 dhe 8, Ligjit mbi Arsimin Para universitar të Republikës së Kosovës nr 04/L-032, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr 10/2018, për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ të MPMS - nr 07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Komuna e Junikut shpallë :

**KONKURS**

Për plotësim e vendit të lirë të punës për vitin shkollor 2018/2019

**Shkolla fillore e mesme e ulët "Edmond Hoxha" në Junik**

Një (1) mësimdhënës/c për lëndët Matematikë 8 orë, Fizikë 8 orë, gjithsejtë 16 orë në javë.

**KUSHTET:**

- Për vendin e lirë të punës për mësimdhënës/e kërkohet përgatitja profesionale përkatëse, në mungesë të kuadrin të kualifikuar vijnë në konsiderim kandidatët me kualifikim të përafërt.

**DOKUMENTACIONI I KËRKUAR:**

1. Diploma (çertifikata),
2. Çertifikata e lindjes,
3. Letërnjoftimi i fotokopjuar,
4. Dëshmi për përvojën e punës,
5. Dëshmi për trajnimet arsimore,
6. Çertifikata e shtetësisë,
7. Çertifikata nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.

Luteni që të dorëzoni vetëm kopjen e vërtetuar/noterizuar të dokumenteve të listuara më lartë. Aplikacioni tërhiqet dhe dorëzohet në Zyrën e pritjes në Junik, dokumentacioni i pakompletuar si dhe ato pas afatit nuk merren në shqyrtim. Afati i konkurimit është 15 ditë nga data e shpalljes në gazetën ditore.

Kandidatet të cilët përzgjidhen në listën e ngushtë për intervistë njoftohen me shkrim ose në telefon në afat ligjor, kandidatet janë të obliguar që të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimin, trajnimet dhe të gjitha ato dokumente të cilat janë dorëzuar në aplikacion, dhe të cilat duhet të verifikohen nga Komisioni intervistues.

Udhëheqësja e personelit:  
*Venera Shala***FERTË PËR SHITJE TË  
SHTËPISË**

Shitet shtëpia dykatëshe, me sipërfaqe prej 218 m<sup>2</sup>, dhe trualli me sipërfaqe prej 410 m<sup>2</sup>.

Shtëpia gjendet në Prishtinë, në lagjen "Aktash I", rr. "Ferhat Draga" nr. 1.

Procedura e transaksionit nga shitësi te blerësi bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe pagesës së çmimit të kontraktuar, pastaj paluejtshmëria e përshtuar më lart kalon te blerësi.

Çmimi sipas marrëveshjes.

**Informata më të hollësishme  
mund të merren në numrin e telefonit  
001-347-331-8305 në Nju Jork, kurse  
në Prishtinë në celularin 044-166-580.**

**AUTOSHKOLLA  
"RITMO - L"****Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë****Eksperiencia jonë  
- përfitimi i juaj.****Ju mirëpret:****Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "****Tel / kontakt:****044 248 173****044 200 604****044 375 333**

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Beqir Gashi" - Mleqan  
 Komuna: Malishevë  
 Data: 17.08.2018

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG /050 - ESIP/SDG/050-CS/1.2	Vizite studimore - gara diturie

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Adresa e Shkollës "Beqir Gashi" Mleqan, Malishevë. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimit të nevojshëm:

- Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:
  - Vizite studimore - gara diturie
- Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
  - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në 5 vitet e fundit;
  - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
- Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve të referencës në adresën e shkolles "Beqir Gashi" Mleqan, Malishevë më së largu deri më 28.08.2018.
- Termet e Referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulentëve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentët lutën që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Fehmi Kryeziu, Zenel Shala  
 Telefoni: 044365635, 044408451  
 E-maili: fehmi6@hotmail.com

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Salih Bytyçi" - Shkozë  
 Komuna: Malishevë  
 Data: 17.08.2018

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/056 - ESIP/SDG/056-CS/1.4	Vizitat e vendeve të ndryshme me karakter mësimi

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës "Salih Bytyçi"-Shkozë-Malishevë. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimit të nevojshme:

- Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:
  - Vizitat e vendeve të ndryshme me karakter mësimi
- Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
  - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
  - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
- Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve të referencës në adresën e shkollës "Salih Bytyçi"- Shkozë-Malishevë. më së largu deri më 28.08.2018.
- Termet e Referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulentëve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentët lutën që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Arben Bytyçi  
 Telefoni: 044536234 & 049446056  
 E-maili: beni-1988@live.com

**OFERTE PËR SHITJEN E PATUNDSHMËRISË**

Blerim (Nuredin ) Berisha, me banim ne fshatin Poslisht K.K. Prizren i pajisur me letërnjoftim - numër personal: 1006612608 të lëshuar nga MPB e Kosovës - Prishtinë, është bashkëpronar me pjesën prej 185/285 e pjesës ideale te patundshmërisë , me numër të Njësia Kadastrale P.nr. 71813067-00566, në vendin e quajtur "Llofka - Llofka ", me kulturë bujqësore arë e kl .4, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2851 m2, Zona Kadastrale Poslisht. Nga pjesa e vet ideale i fron për shitje sipërfaqen prej 500 m2 të patundshmërisë me të dhënat si me lart, në shumën prej 1.000 € për një ari, përkatësisht në shumën e përgjithshme prej 5.000 €, (me shkronja: Pesë mijë euro) .  
 Prizren: 15.08.2018  
 Ofertuesi: Blerim Berisha

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- ▶ Ertan Basha shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHME "Ymer Prizreni " Prizren
- ▶ Fatlinda Kabashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHF "22 Dëshmorët" Randobravë
- ▶ Fatlind Kabashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHF "22 Dëshmorët" Randobravë
- ▶ Fatjon Kabashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHF "22 Dëshmorët" Randobravë
- ▶ Pronari Bajram Musliu, i kompanisë " Global Termo" shpall të pavlefshëm certifikatën e biznesit më numër: 70412333.
- ▶ Lëshoj banesa me qira afër Eulex-it, ish Farmedi, në lagje të spitalit, banesa është e lirë që nga data 01.08.2018. Banesaat janë të ndërtuar nga kompania "Cima Contrekshen" njëra banesë ka 112 metër katror ndërsa tjetra 85 metër katror. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 044-923-527 dhe 044-402-679.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira për një person te huaj. Banesa duhet te jete jo shumë larg qendrës, mundësisht tek "Qafa" ose "Tophane" Duhet te ketë dy dhoma gjumi, te jete e mobiluar bukur. Çmimi deri 300 euro. Për info: Tel 049-472-770
- ▶ Lëshoj me qira banesën në Prishtinë, Lagja Mati 1, rr. Ndue Perllushi (pas 13 katshes). Banesa ka 58 m. katrorë, e mobiluar. Nr. kontaktues 044-121-668 ose 044-172-938. Çmimi sipas marrëveshjes.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151
- ▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155
- ▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.
- ▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783
- ▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshme e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpeite



Me rastin e 20-vjetorit të rënies së Heroit të Kosovës

## **GJENERAL SKËNDER ÇEKU**

Si në çdo përvjetor, edhe këtë vit do të vëmë lule të freskëta mbi varrin tënd. Por, në këtë përvjetor lavdie do të shtohen edhe dy tufa të reja me lule nga nipi dhe mbesa! Ata do të rriten të lumtur në atdheun e lirë dhe do të krenohen me emrin dhe jetën e gjyshit. Vitet do ta ndjekin njëri-tjetrin, stinët do të ndërrohen, por vetëm këto do të mbesin të përherëshme në ne: dhembja, dashuria dhe krenaria për TY!

**Me dhembje të madhe dhe me krenari të përjetshme të kujtojnë: bashkëshortja Ziza, vajzat Saranda dhe Vjosa, djali Albani, nipi Skënderi dhe mbesa Tuana.**

Me rastin e 20-vjetorit të rënies së Heroit të Kosovës

## **GJENERAL SKËNDER ÇEKU**

Vepra jote dhe heroizmi yt do të mbeten udhërrëfyes për ne. Me krenari përmendim emrin tënd.

Lavdi!

**Të përkujton bashkëluftëtari Fatos Çeku me familje.**

